



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 151/10 Prot.,

Datë 22.02.2024

**V E N D I M**

**Nr. 212/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.02.2024 me

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “VIBTIS” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt me Nr. REF-91395-12-18-2023 me fond limit: 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Modifikim i dokumenteve të tenderit për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e sipërcituar të prokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol sh.a  
Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

**Ankimues:** “VIBTIS” SHPK  
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla nr. 2,  
Kati 8/4, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin*”

*e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.12.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. **REF-91395-12-18-2023**, me objekt “**Zëvendësim i pjeshëm i tubacionit magjstral Ø 6” nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje**” me fond limit 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

II.2. Në datën 19.01.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojca me ndryshimet përkatëse në lidhje me procedurën e sipërcituar.

II.3. Në datën 23.01.2024 është depozituar me anë të shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “VIBTIS” Shpk me nr. 151/2024 prot., datë 23.01.2024, duke kërkuar modifikimin e shtojcës së dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht:

“[...]”

**1.- Dokumenti “Shtojcë në DST”, në paragrafin 1, për shtojcën 7 të DST-ve, të këtij tenderi, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 2.3.3. a., është hequr nga stafi drejtues teknik Inxhinieri Mekanik. Inxhinieri Mekanik duhet të jetë kërkesë për staf drejtues teknik për të mbuluar punët e përfshira në preventiv zërin “Punime elektro-mekanike për matje dhe monitorimin e prurjeve në linjë”. Për këtë arsye kërkojmë shtimin e Inxhinierit Mekanik në listën e stafit drejtues teknik. Pra kërkojmë ndryshimin e paragrafit:**

**Është:**

2.3.3. Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, certifikimet.

a) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një).....

**Të bëhet:**

2.3.3. Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, certifikimet.

a) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier mekanik 1 (një)....

**2.- Dokumenti “Shtojcë në DST”, Në shtojcën 7 të DST-ve, të këtij tenderi, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 2.3.5, sipas të cilit:**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e lëshuar nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjësi duhet të figurojë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.

- 5 (pesë) Punonjës specialistë të certifikuar për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë

*për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjësit duhet të figurojnë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet përkatëse.*

**Shënim:** *Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.*

**Shënim:** *Lidhur me standartin EN ISO, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

*Autoriteti kontraktor ka kërkuar kualifikime përsa përket Përgjegjësit për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë dhe Saldatorëve, mirëpo nuk ka kërkuar kualifikime për punonjësit që do të merren me Furnizim-Vendosje të zërave në Preventiv që u përkasin “Punimeve elektro-mekanike për matje dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, artikujt nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48:*

*- Nr. 43, Nr. An, An-R10, F.V Matës smart 6 inch PN64 bar me trasmetim në distancë për naftë.*

*- Nr. 46, Nr. An, An-R11, F.V Saracineske celiku DN = 150 mm , PN 64 bar + Aktuator automatik.*

*- Nr. 48, Nr. An, An-R12, F.V Sensor Presioni”.*

*Sipas dokumentit “Specifikime teknike të ndryshuara”, kapitulli 4 “Elementët kryesorë përbërës të sistemit dhe specifikimet teknike të tyre”, faqe 31-34 (faqe dokumentit) përmendet vazhdimisht që produktet duhet të jenë sipas ATEX, ATEX është një direktivë europiane për përcaktimin e pajisjeve që vendosen në zona me rrezikshmëri shpërthimi. Meqënëse kjo procedurë prokurimi nuk kërkon vetëm Furnizim por Furnizim-Vendosje atëhere edhe stafi inxhinierik i operatorit ekonomik duhet të disponojë kualifikim/specializim për njohuritë e këtyre zonave me rrezikshmëri. Argumentojmë se një staf teknik i pakualifikuar në montimin e pajisjeve të tilla ATEX, mund të shkaktojë pasoja të rënda. Për rrjedhojë stafi inxhinierik që do të bëjë vendosjen e artikujve nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48 sipas zërave të preventivit duhet të ketë kualifikim: “Ex F për njohuritë për ndërgjegjësimin zonave me rrezikshmëri ose ekuivalente”. Ky kualifikim për njohuritë e zonave me rrezikshmëri duhet të disponohet si nga inxhinieri Mekanik dhe inxhinieri Mekatronik që do të kryejnë vendosjen e këtyre artikujve. Artikujt nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48 sipas zërave të preventivit nuk janë vetëm furnizim por Furnizim-Vendosje dhe për këtë arsye operatori ekonomik në mënyrë që të realizojë punimet sipas preventiviit në zërin “Punime elektro-mekanike për matje dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, atëhere duhet të disponojë edhe*

*-Inxhinier Mekanik I (një),*

*-Inxhinier Mekatronik I (një),*

*Për më tepër, për vendosje e zërave në preventiv që u përkasin “Punime elektro-mekanike për*

majte dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, artikujt nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48, të cilat janë pajisje që do të duhet të konfigurohen për të transmetuar apo ndërvepruar me një sistem kontrolli, atëherë inxhinieri mekantronik duhet të disponojë diplomë Master i Shkencave Elektrike Profili Automatizimi i Industrisë. Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktor të bëjë ndryshimet e mëposhtme:

#### **Është:**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë", e lëshuar nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anetarët e BOE.
- 5 (pesë) Punonjës specialistë të certifikuar për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017 Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesis duhet të figurojnë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet përkatëse.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Shënim:** Lidhur me standartin EN ISO, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

#### **TË BËHET:**

2.3.5.- Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë", e lëshuar nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anetarët e BOE.
- 5 (pesë) Punonjës specialistë të certifikuar për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një

organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjësit duhet të figurojnë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet përkatëse.

• **1 (një) Punonjës të disponojë diplomë: Master i Shkencave Elektrike Profili Automatizimi i Industrisë.**

• **2 (dy) Puonjës përkatësisht Inxhinier mekanik dhe inxhinier mekatronik të disponojnë kualifikim: Ex F për njohuritë për ndërgjegjësimin zonave me rrezikshmëri ose ekuivalent”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjësit duhet të figurojnë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve.**

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pikë.

**Shënim:** Lidhur me standartin EN ISO, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

3.- Dokumenti “DST-Zëvendësim tubacioni” ; “Kriteret e veçanta të kualifikimit: 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.3. shkronja b) sipas të cilit:

b). Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, minimalisht inxhinieret si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik                      1 (një)
- Inxhinier Elektronik                        1 (një)

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat inxhinierët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

Autoriteti kontraktues nuk ka vlerësuar drejtë kërkesat që duhet të plotësojë operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, sepse ky projekt nuk mund të zbatohet vetëm me një inxhinier hidroteknik dhe 1 inxhinier elektronik. Zërat e preventivit tek seksioni i “Punime elektro-mekanike për majte dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, përmbajnë artikujt:

- Nr. 43, Nr. An, An-R10, F.V Matës smart 6 inch PN64 bar me trasmetim në distancë për naftë.

- Nr. 46, Nr. An, An-R11, F.V Saracineskë celiku DN = 150 mm , PN 64 bar + Aktuator

automaktik.

- Nr. 48, Nr. An, An-R12, F.V Sensor Presioni”.

Këto artikuj nuk janë vetëm Furnizim por Furnizi-vendosje dhe për këtë arsye operatori ekonomik në mënyrë që të realizojë punimet sipas preventivit në zërin “Punime elektromekanike për majte dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, atëhere duhet të disponojë edhe:

-Inxhinier Mekanik 1 (një);

-Inxhinier Mekatronik 1 (një). Prandaj kërkohet nga autoriteti kontraktor që të marrë parasysh këtë kërkesë dhe të modifikojë të dhënat në DST si më poshtë:

**ËSHTË:**

b). Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmërisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, minimalisht inxhinierët si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat inxhinierët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

**TË BËHET:**

b). Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmërisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, minimalisht inxhinierët si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)
- **Inxhinier Mekanik 1 (një)**
- **inxhinier Mekatronik 1 (një)**

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat inxhinierët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

**4.- Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 22 dhe 23 e dokumentit, kapitulli 6, paragrafi 6.4 Tubi Celikut, sipas të cilit:**

“.....Përbëria kimike (në %) e materialit të tubove duhte të jetë: Karboni (C) jo më tepër se

0.24 dhe jo më pak se 0.17, Mangani (Mn) të mos jetë më tepër se 1.15 por jo më pak se Bakri (Cu) të mos e kalojë vlerën 0.08, Fosfori (P) të mos jetë më tepër se 0.025, Squfuri (S) të mos jetë më tepër se 0.026.

Vetitë mekaniko-fizike të ubove duhet të jenë: Forca elastike të jetë minimalisht 434 N/mm<sup>2</sup>. Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 270Mpa.

.....

*Të dhënat kryesore të tubit*

*Standardi; API 5L ose ekuivalent*

*Grada e celikut: A , A25*

*Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 172 Mpa*

*Diametri i jashtëm: 6'' (150mm)*

*Spesori: 6.35 mm*

*Gjatësia: 6-12m*

.....

*Kërkesat teknike të kërkuara nuk janë në përputhje me standardin API 5L apo me ekuivalentët e tij.*

*Së pari: tek paragrafi për të dhënat kryesore të Tubit dimensionet e tubit është kërkuar diametri i jashtëm 6in (150mm). Kjo kërkesë nuk përputhet me API 5L, i cili për dimensionet e tubove referon standardin ASME B36.10M, ku në faqen 5, Tabela 1, përcakton diametrin nominal 6in (150mm) ndërsa diametri i jashtëm 6.625in (168.3mm). Më poshtë gjeni tabelën e përkthyer nga standardi ASME B36.10M për referencë:*



Dimensionet dhe peshat e tubove celiku te farketuar te salduara dhe pa saldim									
Njesi amerikane				Identifikimi [Standard (STD), Shume I forte (XS), Dy here me I forte (XXS)]	Nr. Skedulit	DN	Njesi SI		
NPS	Diametri I jashtem [in.]	Spesori [in]	Pesha I Fundi I sheshte [lb/ft]				Diametri I jashtem [mm]	Spesori [mm]	Masa e Fundi I sheshte [kg/m]
3 1/2	4.000	0.226	9.12	STD	40	90	101.6	5.74	13.57
3 1/2	4.000	0.250	10.02	...	...	90	101.6	6.35	14.92
3 1/2	4.000	0.281	11.17	...	...	90	101.6	7.14	16.63
3 1/2	4.000	0.318	12.52	XS	80	90	101.6	8.08	18.64
4	4.500	0.083	3.92	...	5	100	114.3	2.11	5.84
4	4.500	0.109	5.12	...	...	100	114.3	2.77	7.62
4	4.500	0.120	5.62	...	10	100	114.3	3.05	8.37
4	4.500	0.125	5.85	...	...	100	114.3	3.18	8.71
4	4.500	0.141	6.57	...	...	100	114.3	3.58	9.78
4	4.500	0.156	7.24	...	...	100	114.3	3.96	10.78
4	4.500	0.172	7.96	...	...	100	114.3	4.37	11.85
4	4.500	0.188	8.67	...	30	100	114.3	4.78	12.91
4	4.500	0.203	9.32	...	...	100	114.3	5.16	13.89
4	4.500	0.219	10.02	...	...	100	114.3	5.56	14.91
4	4.500	0.237	10.80	STD	40	100	114.3	6.02	16.08
4	4.500	0.250	11.36	...	...	100	114.3	6.35	16.91
4	4.500	0.281	12.67	...	...	100	114.3	7.14	18.87
4	4.500	0.312	13.97	...	...	100	114.3	7.92	20.78
4	4.500	0.337	15.00	XS	80	100	114.3	8.56	22.32
4	4.500	0.438	19.02	...	120	100	114.3	11.13	28.32
4	4.500	0.531	22.53	...	160	100	114.3	13.49	33.54
4	4.500	0.674	27.57	XXS	...	100	114.3	17.12	41.03
5	5.563	0.083	4.86	...	...	125	114.3	2.11	7.24
5	5.563	0.109	6.36	...	5	125	114.3	2.77	9.46
5	5.563	0.125	7.27	...	...	125	114.3	3.18	10.83
5	5.563	0.134	7.78	...	10	125	114.3	3.40	11.56
5	5.563	0.156	9.02	...	...	125	114.3	3.96	13.41
5	5.563	0.188	10.80	...	...	125	114.3	4.78	16.09
5	5.563	0.219	12.51	...	...	125	114.3	5.56	18.61
5	5.563	0.258	14.63	STD	40	125	114.3	6.55	21.77
5	5.563	0.281	15.87	...	...	125	114.3	7.14	23.62
5	5.563	0.312	17.51	...	...	125	114.3	7.92	26.05
5	5.563	0.344	19.19	...	...	125	114.3	8.74	28.57
5	5.563	0.375	20.80	XS	80	125	114.3	9.53	30.97
5	5.563	0.500	27.06	...	120	125	114.3	12.70	40.28
5	5.563	0.625	32.99	...	160	125	114.3	15.88	49.12
5	5.563	0.750	38.59	XXS	...	125	114.3	19.05	57.43
6	6.625	0.083	5.80	...	...	150	168.3	2.11	8.65
6	6.625	0.109	7.59	...	5	150	168.3	2.77	11.31
6	6.625	0.125	8.69	...	...	150	168.3	3.18	12.95
6	6.625	0.134	9.30	...	10	150	168.3	3.40	13.83
6	6.625	0.141	9.77	...	...	150	168.3	3.58	14.54
6	6.625	0.156	10.79	...	...	150	168.3	3.96	16.05
6	6.625	0.172	11.87	...	...	150	168.3	4.37	17.67
6	6.625	0.188	12.94	...	...	150	168.3	4.78	19.28
6	6.625	0.203	13.94	...	...	150	168.3	5.16	20.76
6	6.625	0.219	15.00	...	...	150	168.3	5.56	22.31
6	6.625	0.250	17.04	...	...	150	168.3	6.35	25.36
6	6.625	0.280	18.99	STD	10	150	168.3	7.11	28.26

Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të Dimensionit të jashtëm kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Spcifikimet teknike, pika 3.

Së dyti, tek paragrafi për të dhënat kryesore të tubit është kërkuar grada A, A 25 sipas API 5L. Kjo kërkesë nuk përputhet me kërkesat e standardit API 5L ku në faqen 21, tabela 2, është përcaktuar që grada A25 është e limituar për tubo me diametër më të vogël se 141.3mm (5.563in) [ $D \leq 141.3\text{mm}$  (5.563in)]. Ju lutemi të gjeni më poshtë tabelën e referencës të përkthyer nga standardi API 5L:

Tabela 2-Proceset e prodhimit të pranueshme dhe PSL

Tabela2- Proceset e Prodhimit te Pranueshme dhe PSL

Lloji I tubos ose I fundit te tubos	Tubo Grade PSL 1					Tubo Grade PSL 2		
	L175 ose A25 <sup>b</sup>	L175P ose A25P <sup>b</sup>	L210 ose A	L245 ose B	L290 ose X42 deri ne L485 ose X70	L245 ose B deri ne L555 ose X80	>L555 ose X80 deri ne L690 ose X100	>L690 ose X100 deri ne L830
								ose X120
Lloji I tubos								
SMLS	X	X	X	X	X	X	X	-
CW	X	X	-	-	-	-	-	-
LFW	X	-	X	X	X	-	-	-
HFW	X	-	X	X	X	X	-	-
LW	-	-	-	-	X	-	-	-
SAWL <sup>c</sup>	-	-	X	X	X	X	X	X
SAWH <sup>d</sup>	-	-	X	X	X	X	X	X
COWL <sup>c</sup>	-	-	X	X	X	X	-	-
COWH <sup>d</sup>	-	-	X	X	X	X	-	-
Lloji I fundit te tubos								
Fund me trashje <sup>e</sup>	X	-	X	X	X	-	-	-
Fund I sheshte	X	-	X	X	X	X	X	X
Fund I sheshte per manikota speciale	X	-	X	X	-	-	-	-
Fund me fileta <sup>f</sup>	X	X	X	X	-	-	-	-
<p>a Grada ndermjetese jane te mundshme nese dakortesohen, por te limituara ne grada me te larta se L290 ose X42</p> <p>b Gradat L175, L175P, A25 dhe A25P jane te limituara deri ne tubo me D ≤ 141.3 mm (5.563 in)</p> <p>c Tubot dy tegele saldimi jane te mundshme nese dakortesohet, por te limituara ne tubo me D ≥ 914 mm (36.000 in)</p> <p>d Tubo me tegel saldimi spirale jane te limituara ne tubo me D ≥ 114.3mm (4.500 in)</p> <p>e Tubo me funde me trashje jane te limituara ne tubo me D ≤ 219.1 mm (8.625 in) dhe t ≤ 3.6 mm (0.141 in)</p> <p>f Tubot me funde me fileta jane te limituara ne SMLS dhe tubo me tegel saldimi gjatesor me D ≤ 508 mm (20.000 in)</p>								

Projektuesi ka specifikuar një standard në kundërshtim me të dhënat kryesore objekt prokurimi, i cili është diametri i jashtëm i tubacionit që është 168.3mm. Pra operatori ekonomik nuk duhet ti jepet e drejta të marri pjesë në procedurë me një tub celiku me diametër 168.3mm dhe gradë celiku A25, sepse nuk e lejon standardi referencës. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të Gradës Celikut kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Specifikimet teknike, pika 3.

Së treti, tek paragrafi për të dhënat kryesore të tubit është përzgjedhur grada A, A25 të cilat janë grada inferiore përkundrejt gradës B të API 5L. Përbërja kimike celikut Grada A sipas API 5L e bën më të presdispozuar për korrozion të parakohshëm kundrejt gradës B për shkak të përqindjes së karbonit, kjo duke marrë parasysh dhe përmbajtjen e lartë të H2S të cituar në Relacionin teknik të ndryshuar pdf. Gjithashtu, Grada B e standardit API 5L ka një limit më të lartë të forcës elastike dhe qëndrueshmërisë maksimale çka e bën më rezistente ndaj sforcimeve mekanike që mund të shkaktojnë çarje të tubit. Prandaj projektuesi në vend të lejonte Gradën A dhe Gradën A25 (gradë inferiore ndaj Gradës A dhe e papërshtatshme për diametrin e tubit

sipas parashtrimit më lart) si të përshtatshme, do të duhej të specifikonte duke lejuar një gradë më të mirë se Grada A pra: Grada A ose Gradën B ose ekuivalent”.

Së katërti, janë dhënë dy vlera për kufirin minimal të rrjedhshmërisë. në faqen 22 kërkohet kufiri i rrjedhshmërisë minimalisht 270Mpa, ndërsa në faqen 23, paragrafi të dhënat kryesore të tubit, kërkohet që kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 172Mpa. Për tu theksuar më tej që të dyja këto nuk përputhen me kërkesat e standardit API 5L, i cili parashikon kufirin e rrjedhshmërisë për Gradën A të jetë minimalisht 210Mpa. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të vetisë mekanike-fizike kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Spcifikimet teknike, pika 3.

Së pesti, tek paragrafi për kërkesat e përbërjes kimike të tubit nuk janë në përputhje me standardin API 5L sipas tabelës 1. Përbërjet kimike sipas API 5L paraqitur më poshtë:

tabela 1 –Përbërjet kimike API 5L

Tabela 1 - Perberjet kimike sipas API 5L

Standardi Parametrat	Specifikimet teknike sipas dokumentit “Specifikimet Teknike te ndryshuara.pdf”	Krahasuar me	Specifikimet teknike sipas standartit API 5L
	Grada A,		Grada A
Karboni (C) [%]	0.17 deri ne0.24		Max 0.22
Mangani (Mn)[%]	0.44 deri ne 1.15		Max 0.90
Bakri (Cu)[%]	Max 0.08		Max 0.5
Fosfori (P)[%]	Max 0.025		Max 0.03
Squfur (S)[%]	Max 0.026		Max 0.03

Projektuesi ka specifikuar diapaznone të përbërjes kimike tubit në kundërshtim me përcaktimet e standardid referencë API 5L Grada A. Projektuesi nuk mundet të specifikojë të dhëna të tilla të përbërjes kimike pa u bazuar në standard. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e vetive kimike kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Spcifikimet teknike, pika 3.

Së gjashti, tek paragrafi për të dhënat kryesore të tubit është përmendur standardi API 5L ose ekuivalent. Atëhere ne kemi marrë në analizë standardin API 5L dhe standardet ekuivalente (EN 10216-2 dhe ASTM A106M) të tij përse përket përbërjes kimike dhe vetive mekanike të grada A kërkuar dhe të gradës B. Më poshtë gjeni analizën e detajuar krahasimore midis specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentin “Specifikime teknike të ndryshuara pdf” dhe specifikimeve teknike të referencës:

Standardi Parametrat	Specifikimet teknike sipas dokumentit “Specifikimet Teknike te ndryshuara.pdf” Grada A	Krahasuar me	Specifikimet teknike sipas standartit API 5L		Specifikimet teknike sipas standartit EN 10216-2	Specifikimet teknike sipas standartit ASTM 106M	
			Grada A	Grada B	P265GH	Grada A	Grada B
Karboni (C) [%]	0.17 deri ne0.24		Max 0.22	Max 0.28	Max 0.2	Max 0.25	Max 0.30
Mangani (Mn)[%]	0.44 deri ne 1.15		Max 0.90	Max 1.2	Max 1.4	0.27 deri ne 0.93	0.29-1.06
Bakri (Cu)[%]	Max 0.08		Max 0.5	Max 0.5	Max 0.3	Max 0.4	Max 0.4
Fosfori (P)[%]	Max 0.025		Max 0.03	Max 0.03	Max 0.025	Max 0.035	Max 0.035
Squfur (S)[%]	Max 0.026		Max 0.03	Max 0.03	Max 0.02	Max 0.035	Max 0.035
Forca elastike [N/mm2]	Min 434		Min 335	Min 415	410 deri ne 570	Min 330	Min 415
Kufiri i rrjedhshmerise [Mpa]	Min 270		Min 210	Min 245	Min 265	Min 205	Min 240

Projektuesi ka specifikuar diapazone të përbërjes kimike dhe të vetive mekaniko-fizike tubit në kundërshtim me përcaktimet e standardit referencë API 5L Grada A dhe të standardeve ekuivalente. Projektuesi nuk mundet të specifikojë të dhëna të tilla të përbërjes kimike dhe të vetive mekaniko-fizike pa u bazuar në standard. Në rastet kur standardi përcakton vetëm kufirin maksimal, atëherë projektuesi nuk mund të vendosi diapazon edhe për kufirin minimal për aq kohë sa standardi përcakton vetëm kufij maksimal. Në këto raste projektuesi duhet të marrë për bazë vetëm kufirin më të lartë maksimal që lejon standardi i përcaktuar apo ekuivalentet e tij. Në rastet kur standardi përcakton vetëm kufij minimal, atëherë projektuesi nuk mund të përcaktojë një kufi minimal të ndryshëm nga standardi përcaktuar apo ekuivalent i tij. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e përbërjes kimike dhe të vetive mekaniko-fizike kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Specifikimet teknike, pika 3. Duke u bazuar në pikat e mësipërme, ne si operator ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në këtë tender, kërkojmë të bëhen ndryshimet e mëposhtme në dokumentin “Specifikime teknike të ndryshuar pdf.”.

Së pari, paragrafi:

**Është:**

“.....Përbëria kimike (në %) e materialit të tubove duhte të jetë: Karboni (C) jo më tepër se 0.24 dhe jo më pak se 0.17, Mangani (Mn) të mos jetë më tepër se 1.15 por jo më pak se Bakri (Cu) të mos e kalojë vlerën 0.08, Fosfori (P) të mos jetë më tepër se 0.025, Squfuri (S) të mos jetë më tepër se 0.026.

Vetitë mekaniko-fizike të ubove duhet të jenë: Forca elastike të jetë minimalisht 434 N/mm<sup>2</sup>. Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 270 Mpa.

**Të bëhet:**

“.....Përbëria kimike (në %) e materialit të tubove duhte të jetë: Karboni (C) jo më tepër se 0.3, Mangani (Mn) të mos jetë më tepër se 1.4, Bakri (Cu) të mos e kalojë vlerën 0.5, Fosfori (P) të mos jetë më tepër se 0.035, Squfuri (S) të mos jetë më tepër se 0.035.

Vetitë mekaniko-fizike të ubove duhet të jenë: Forca elastike të jetë minimalisht 330 N/mm<sup>2</sup>. Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 205 Mpa.

Së dyti, paragrafi:

**Është:**

Të dhënat kryesore të tubit

Standardi: API 5L ose ekuivalent

Grada e celikut: A , A25

Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 172 Mpa

Diametri i jashtëm: 6’’ (150mm)

Spesori: 6.35 mm

Gjatësia: 6-12m

**Të bëhet:**

Të dhënat kryesore të tubit

Standardi; API 5L ose ekuivalent

Grada e celikut: Grada A ose Grada B/ ose Ekuivalent

Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 205 Mpa

*Diametri i jashtëm: 6.625in (168.3mm)*

*Spesori: 6.35 mm*

**5-** Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 32 e dokumentit, kapitulli 8, paragrafi 8.4 pika a, Matës i tipit CORIOLIS, sipas të cili kërkohet:

*‘.....Montimi: M Fallanxha DN150 PN64 sipas DIN2501/EN1092-1” bie në kundërshtim me Kapitullin VI, seksioni 6.1 Të përgjithshme, paragrafi fundit, sipas të cilit:*

*“Të gjitha vlerësimet e presionit/temperaturës për komponentët me fllanxha duhet të jetë në përputhje me ASME B16.5 përveç kasteve kur parashikohet ndryshe...”*

*Projektuesi ka për detyrë të saktësojë në mënyrë të qartë standardet për tu përdorur. Nëpërmjet këtyre specifikimeve projektuesi ka përmend dhe standartet amerikane ASME dhe europiane sipas DIN. Projekti në mënyrë që të zbatohet saktë duhet të ketë unifikim të standardeve, për këtë arsye projektuesi duhet të saktësojë që komponentët e fallanxhave që do të furnizohen duhet të jenë të gjitha ose sipas standardeve amerikane ASME ose sipas atyre europiane. Prandaj kërkohet nga autoriteti kontraktor të bëjë ndryshimet e mëposhtme:*

*Është:*

*“...Montim me Fallanxha DN150 PN64 sipas DIN2501/EN1092-1”*

*Të bëhet:*

*“..Montim me Fallanxha DN150 PN 64 sipas DIN2501/EN1092-1 ose ASME B16.5 ekuivalente”*

**6-** Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 31 e dokumentit, kapitulli 8, paragrafi 8.4 pika a, Matës i tipit CORIOLIS, Transmetuesi, ka gabime të përcaktimit e të dhënave të këtij produkti. Kërkesat teknike për këtë pajisje janë të pasakta. Transmetuesi është një pajisje elektronike që nuk ka lidhje fizike me tubacionin. Transmetuesi lidhet nëpërmjet kabullit me sensorin e matësit Coriolis. Transmetuesi nuk ka kontakt me naftën. Për këtë arsye, të dhënat e mëposhtme janë të pasakta dhe nuk i përkasin kësaj pajisje:

*-Diametri DN 150mm,*

*-Lëngu: Naftë Bruto.*

*Këto të dhëna duhet të hiqen nga kërkesat e specifikimeve teknike.*

**7-** Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 31 e dokumentit, kapitulli 8, paragrafi 8.4 pika a, Matës i tipit CORIOLIS, është kërkuar që matësi i tipit Coriolis të ketë komunikim nëpërmjet protokollit MODBUS, PROFIBUS DP, EtherNet/IP, PROFINET, MODBUS TCP, **Ëeb**server ne Ethernet dhe gjithashtu është kërkuar që kjo pajisje të ketë certifikim MID. Një matës me këto protokolle komunikimi nuk mund të certifikohet sipas MID.

Gjithashtu, në mënyrë që të përcaktohej saktë Matësi Coriolis, atëhere projektuesi duhet të jepte të dhënat si më poshtë:

-Diapazoni i prurjeve minimale-maksimale;

-Viskoziteti i fluidit (cP);

-Klasifikimi i zonë dhe lloji i mbrotjes ATEX.

Në mënyrë që të përmasohet Matësi i Tipit Coriolis atëhere projektuesi dhe për rrjedhojë autoriteti kontraktues duhet të ndryshojë specifikimet teknike të këtij produkti duke shtuar edhe parametrat e mësipërme. Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktortë marrë parasysht këtë ndryshim.

**8-** Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 23 e relacionit, paragrafi 6.4 Tubi i Celikut, “...Për të vërtetuar cilësinë, duhet të paraqiten certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me celik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit (me markim CE) në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European”, Kërkesa për markim CE të tubit të celikut tregon qartë se projektuesi dhe për rrjedhojë autoriteti kontraktor që ka shpall procedurën e prokurimit bazuar mbi këto specifikime nuk ka bërë interpretimin e duhur mbi direktivën 68, të vitit 2014. Kjo për arsye se tubot e shitur individualisht dhe jo pjesë të një pajisje apo asemblimi nuk mund të markohen CE. Markohen CE vetëm Pajisja ose Asemblim Komponentësh. Për këtë interpretim i referohemi Udhëzuesit lidhur me Direktivën e Enëve nën Presion 2014/68/UE (PED), Udhëzimit A-09 të Komisionit Grupit Punës “Presioni” (ĒGP) i miratuar prej tij në 08/01/2016. Prandaj kërkojmë që paragrafi:

**Është:**

“.....Për të vërtetuar cilësinë, duhet të paraqiten certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me celik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit (me markim CE) në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European..”.

**Të bëhet:**

“...Për të vërtetuar cilësinë, duhet të paraqiten certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me celik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European”.

**9-** Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 32 e dokumentit, paragrafi c, Saracineska Automatike, ku Motor kontrolli për saracineskë elektrike ON/OFF është kërkuar me furnizim njëfazor ndërsa në dokumentin “5.Projekti Elektrik. pdf”, Numri Fletës P-08, furnizimi është projektuar me linjë trefazore (3P+N). Pra, projektuesi dhe për rrjedhojë autoriteti kontraktor që ka shpallur procedurën e prokurimit bazuar mbi këtë dokument ka mangësi në përcaktimin e duhur të linjës elektrike dhe për këtë arsye pajisjet nuk mund të operojnë. Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktor të ndërhyjë për të korrigjuar këtë konfuzion në përcaktimin e linjës furnizimit të Aktuatorit Elektrik dhe Specifikimeve Teknike të Aktuatorit Elektrik.

**10-** Dokumenti “3.Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 28 e dokumentit, Kapitulli 8, paragrafi 8.2, Mënyra e Funksionimit të Sistemit”, projektuesi ka specifikuar që duhet parashikuar kontrolli automatik i valvolave ON-OFF, por nuk ka parashikuar Pasojnë në rast se mbyll valvulën në mënyrë automatike se çfarë ndodh më tej me grupin e pompimit. Projektuesi në mënyrën e Funksionimit të Sistemit duhet të kishte parashikuar edhe kontrollin e grupit të popimit. Në rast se valvula mbyllet automatikisht ndërkohë që grupi i popimit vazhdon të qëndrojë në punë, atëherë në tubacion krijohet rritje presioni dhe më tej shpërthim. Projektuesi duhet të kishte parashikuar kontrollin automatik edhe të grupit të pompimit, i cili do të mundësonte fikjen emergjente të grupit të popimit në të njëjtën kohë që mbyllet edhe valvula ON-OFF. Ky funksion duhet të ishte pjesë e një sistemi të vetëm komunikimi, por projektuesi e ka bërë pjesërisht duke mos ndërlidh komunikimin me gjithë sistemin dhe për pasojë rrezikimin e jetës dhe sigurisë në punë. Për sa më lart kjo ishte detyrë e Projektuesit për ta parashikuar dhe më tej autoriteti kontraktor që ka pranuar këtë projekt për ta shpallur në procedurë prokurimi. Mungesa e trajtimit të duhur të kësaj çështje mund të shkaktojë dëme me pasojë për punonjësit e autoritetit kontraktues dhe nënkontraktorëve të cilët punojnë me zonën e tubacionit dhe stacioneve pompimit.

**11-** Mungesë në dokumentacion: Autoriteti kontraktor ka publikuar një procedurë prokurimi me mangësi në dokumentacion e projektit. Një projekt i detajuar i kryer nga një kompani me eksperiencë në sektorin e tubacioneve për naftë bruto, si pjesë të projektit detajuar duhet të kishte dorëzuar shtesë edhe listën e mëposhtme të dokumentave:

- Diagrama e tubacionit dhe instrumentave (P&ID);
- Llogaritjet e sforcimeve mekanike të tubacionit;
- Isometria e Linjës së tubacionit;
- Skema elektrike detajuar e lidhje të pajisjeve elektro-mekanike;
- Diagrama dhe vizatimi e Panelit të Kontrollit për pajisjet elektro-mekanike;
- Matrica Shkak-Pasojë;
- Klasifikimi i zonave të rrezikshmërisë ATEX;
- Sistemi i ndalimit emergjent;
- Llogaritjet e Përmasimit të Kalimatësit Coriolis;
- Lista e sinjaleve hyrëse/dalëse (I/O) dhe Herat e Alarmeve të sinjaleve

Të gjitha vërejtjet më lart janë demonstrim i faktit që projektuesi i caktuar për hartimin e këtij projekti nuk ka eksperiencë të mëparshme projektimi tubacioni naftë bruto, nuk ka dijenitë e duhura për specifikimin e pajisjeve elektro-mekanike dhe nuk ka njohuritë e duhura përsa i përket klasifikimit të zonave ATEX. Integriteti i dokumentacionit teknik të projektit është i cënuar. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor po gabon duke publikuar një procedurë prokurimi bazuar mbi një projekt i cili është i pa saktë. Në mënyrë të menjëhershme pas vënies në dijeni të këtij ankimi, autoriteti kontraktor duhet të ndërhyjë për modifikimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit dhe të hartojë projektin e saktë bazuar në standarde dhe normativat e duhura për projektimin e tubacioneve të transportimit naftës bruto. Modifikimi i specifikimeve teknike, është i domosdoshëm për shkak të shkeljeve të rënda teknike në dokumentet teknike, të cilat nëse nuk korrigjohen do të sjellin dëme ekonomike, mjedisore dhe njerëzore. Në këto kushte, mos veprimi nga ana e autoritetit kontraktor, sjell pasojë, për të cilat mbahet përgjegjësi administrative dhe ligjore [...]”.

II.4. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Me informacionin e ardhur me shërbimin postar me nr.635/1 prot., datë 3001.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, me nr. 151/3 prot., datë 01.02.2024, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk. Referuar informacionit të mësipërm rezulton, se ky i fundit e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim e ka **pranuar pjesërisht atë**.

*Konkretisht, autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht:*

**6-** Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 31 e dokumentit, kapitulli 8, paragrafi 8.4 pika a, Matës i tipit CORIOLIS, Transmetuesi, ka gabime të përcaktimit e të dhënave të këtij produkti. Kërkesat teknike për këtë pajisje janë të pasakta. Transmetuesi është një pajisje elektronike që nuk ka lidhje fizike me tubacionin. Transmetuesi lidhet nëpërmjet kabullit me sensorin e matësit Coriolis. Transmetuesi nuk ka kontakt me naftën. Për këtë arsye, të dhënat e mëposhtme janë të pasakta dhe nuk i përkasin kësaj pajisje:

*-Diametri DN 150mm,*

*-Lëngu: Naftë Bruto.*

*Këto të dhëna duhet të hiqen nga kërkesat e specifikimeve teknike.*

**Lidhur me pretendimet për specifikimet teknike të materialeve dhe pajisjeve të kërkuara KSHA ka komunikuar me projektuesin dhe ka kërkuar prej tij të japë opinionet dhe argumentimet përkatëse lidhur me pretendimet në ankesë. Pas komunikimit dhe argumentave të dhënë nga projektuesi, arsyetojmë: Pretendimi i OE ankimues qëndron dhe duhen të hiqen nga specifikimet teknike të dhënat si më poshtë:**

*-Diametri DN 150mm,*

*-Lëngu: Naftë Bruto.*

**Si konkluzion, pretendimi për këtë pikë qëndron.**

**9-** Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 32 e dokumentit, paragrafi c, Saracineska Automatike, ku Motor kontrolli për saracineskë elektrike ON/OFF është kërkuar me furnizim njëfazor ndërsa në dokumentin “5.Projekti Elektrik. pdf”, Numri Fletës P-08, furnizimi është projektuar me linjë trefazore (3P+N). Pra, projektuesi dhe për rrjedhojë autoriteti kontraktor që ka shpallur procedurën e prokurimit bazuar mbi këtë dokument ka mangësi në përcaktimin e duhur të linjës elektrike dhe për këtë arsye pajisjet nuk mund të operojnë. Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktor të ndërhyjë për të korrigjuar këtë konfuzion në përcaktimin e linjës furnizimit të Aktuatorit Elektrik dhe Specifikimeve Teknike të Aktuatorit Elektrik.



***Lidhur me pretendimet për specifikimet teknike të materialeve dhe pajisjeve të kërkuara KSHA ka komunikuar me projektuesin dhe ka kërkuar prej tij të japë opinionet dhe argumentimet përkatëse lidhur me pretendimet në ankesë. Pas komunikimit dhe argumentave të dhënë nga projektuesi, arsyetojmë: Pretendimi i OE ankimues qëndron dhe duhen të ndryshohen specifikimet teknike si më poshtë:***

*-Motorët –Motor trefazor AC;*

*-Voltazhet standarde – Rrymë trefazore AC;*

**Si konkluzion, pretendimi për këtë pikë qëndron.**

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën në përputhje me këto pretendime të pranuar. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të marrë masa për publikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, të shtojcës për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në përputhje me pretendimin e pranuar pjesërisht.

II.6. Nga shyrtimi i ankesës rezulton, objekti i saj lidhet kërkuar modifikim i shtojcës së dokumenteve standarde të tenderit si dhe të specifikimeve teknike të ndryshuara pdf, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga ana e operatorit ekonomik “VIBTIS” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Me qëllim gjykimin e ankesës të paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore në mjediset e institucionit tonë, me përfaqësues ekspert fushe të operatorit ekonomik “VIBTIS” SHPK, një përfaqësues ekspert fushe, anëtar i njësisë së prokurimit si dhe përfaqësues ekspert fushe, jo-anëtar i njësisë së prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor, të cilët ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur për hartimin e shtojcës së dokumenteve standarde të tenderit si dhe të specifikimeve teknike të ndryshuara pdf, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e premte, datë 16.02.2024 ora 11:00. Për këtë qëllim iu drejtua palëve në proces ankimi administrativ, me shkresën nr. 151/4 prot., datë 13.02.2024.

II.7. Në seancën dëgjimore të datës 16.02.2024 të zhvilluar në mjediset e KPP-së në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, me anë të autorizimit nr. 90 prot., datë 14.02.2024 nga administratoi i shoqërisë “VIBTIS” SHPK, u paraqit përfaqësuesi i operatorit ekonomik “VIBTIS” Shpk, Z. J. B., identifikuar me ID numër J61126061Q, në pozicionin e inxhinierit Mekatronik, dhe Znj. E.H. ,, përfaqësues nga operatori ekonomik “VIBTIS” SHPK identifikuar me me ID numër I45217071J. Ndërsa përfaqësues të autoritetit kontraktor Albpetrol sh.a., Z. E. GJ., me detyrë ekspert fushe, në cilësinë e anëtarit në procedurën e prokurimit, objekt ankimi identifikuar me ID numër J10521121U dhe Z. E. Q., përfaqësues ligjor i shoqërisë “Hydro-eng Consulting” SHPK, si ekspert i fushës, në cilësinë e hartuesit të projektit dhe specifikimeve teknike, të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Përfaqësuesit e operatorit ekonomik ankimues dhe të autoritetit kontraktor nuk kishin ndonjë kontestim gjatë seancës degjimore. Seanca dëgjimore u regjistrua në audio.

II.8. Njëpërmjet shkresës me nr. 109 prot., datë 19.02.2024 ( me postë), protokolluar me tonën me nr. 151/5 prot., datë 19.02.2024 me objekt “*Dërgim informacioni shtesë*” është depozituar nga ana e operatorit ekonomik ankimes “VIBTIS” SHPK, në Komisionin e Prokurimit Publik informacion shtesë, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Njëpërmjet shkresës me nr. 151/6 prot., datë 21.02.2024 (dërguar me e-mail), Komisionin e Prokurimit Publik i kërkoi informacion autoritetit kontraktor lidhur me komunikimin e patur me Agjencinë e Prokurimit Publik, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Njëpërmjet e-mail të dërguar, protokolluar me tonën me nr. 151/7 prot., datë 22.02.2024 është depozituar nga ana e autoritetit kontraktor, informacion i kërkuar, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Arsyeton:

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

III.1. Në datën 19.12.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur*” me Nr. **REF-91395-12-18-2023**, me objekt “***Zëvendësim i pjeshëm i tubacionit magjistral Ø 6" nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje***” me fond limit 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

III.1.1. Në datën 23.01.2024 është depozituar me anë të shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “VIBTIS” Shpk me nr. 151/2024 prot., datë 23.01.2024, duke kërkuar modifikimin e shtojcës së dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Me informacionin e ardhur me shërbimin postar me nr.635/1 prot., datë 30.01.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, me nr. 151/3 prot., datë 01.02.2024, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes “VIBTIS” Shpk. Referuar informacionit të mësipërm rezultoi, se ky i fundit e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe në përfundim e ka **pranuar pjesërisht atë**.

*Konkretisht, autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht:*

**6-** Dokumenti “*Specifikime teknike të ndryshuara. pdf*” Faqe 31 e dokumentit, kapitulli 8, paragrafi 8.4 pika a, Matës i tipit CORIOLIS, Transmetuesi, ka gabime të përcaktimit e të dhënave të këtij produkti. Kërkesat teknike për këtë pajisje janë të pasakta. Transmetuesi është një pajisje elektronike që nuk ka lidhje fizike me tubacionin. Transmetuesi lidhet njëpërmjet kabullit me sensorin e matësit Coriolis. Transmetuesi nuk ka kontakt me naftën. Për këtë arsye,

të dhënat e mëposhtme janë të pasakta dhe nuk i përkasin kësaj pajisje:

-Diametri DN 150mm,

-Lëngu: Naftë Bruto.

Këto të dhëna duhet të hiqen nga kërkesat e specifikimeve teknike.

**Lidhur me pretendimet për specifikimet teknike të materialeve dhe pajisjeve të kërkuara KSHA ka komunikuar me projektuesin dhe ka kërkuar prej tij të japë opinionet dhe argumentimet përkatëse lidhur me pretendimet në ankesë. Pas komunikimit dhe argumentave të dhënë nga projektuesi, arsyetojmë: Pretendimi i OE ankimes qëndron dhe duhen të hiqen nga specifikimet teknike të dhënat si më poshtë:**

-Diametri DN 150mm,

-Lëngu: Naftë Bruto.

**Si konkluzion, pretendimi për këtë pikë qëndron.**

9-. Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 32 e dokumentit, paragrafi c, Saracineska Automatike, ku Motor kontrolli për saracineskë elektrike ON/OFF është kërkuar me furnizim njëfazor ndërsa në dokumentin “5.Projekti Elektrik. pdf”, Numri Fletës P-08, furnizimi është projektuar me linjë trefazore (3P+N). Pra, projektuesi dhe për rrjedhojë autoriteti kontraktor që ka shpallur procedurën e prokurimit bazuar mbi këtë dokument ka mangësi në përcaktimin e duhur të linjës elektrike dhe për këtë arsye pajisjet nuk mund të operojnë. Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktor të ndërhyjë për të korrigjuar këtë konfuzion në përcaktimin e linjës furnizimit të Aktuatorit Elektrik dhe Specifikimeve Teknike të Aktuatorit Elektrik.

**Lidhur me pretendimet për specifikimet teknike të materialeve dhe pajisjeve të kërkuara KSHA ka komunikuar me projektuesin dhe ka kërkuar prej tij të japë opinionet dhe argumentimet përkatëse lidhur me pretendimet në ankesë. Pas komunikimit dhe argumentave të dhënë nga projektuesi, arsyetojmë: Pretendimi i OE ankimes qëndron dhe duhen të ndryshohen specifikimet teknike si më poshtë:**

-Motorët –Motor trefazor AC;

-Voltazhet standarde – Rrymë trefazore AC;

**Si konkluzion, pretendimi për këtë pikë qëndron.**

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin

e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën në përputhje me këto pretendime të pranuar. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të marrë masa për publikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, të shtojcës për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në përputhje me pretendimin e pranuar pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendosi të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: “I.- Dokumenti “Shtojcë në DST”, në paragrafin 1, për shtojcën 7 të DST-ve, të këtij tenderi, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 2.3.3. a., është hequr nga stafi drejtues teknik Inxhinieri Mekanik. Inxhinieri Mekanik duhet të jetë kërkesë për staf drejtues teknik për të mbuluar punët e përfshira në preventiv zërin “Punime elektro-mekanike për matje dhe monitorimin e prurjeve në linjë”. Për këtë arsye kërkojmë shtimin e Inxhinierit Mekanik në listën e stafit drejtues teknik. Pra kërkojmë ndryshimin e paragrafit:

**Është:**

2.3.4. Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, certifikimet.

b) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqcrisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një).....

**Të bëhet:**

2.3.4. Stafë kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, certifikimet.

b) Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)....

”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën e datës 19.01.2024 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, 2.3.3-a) autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Në Shtojcën 7 të DST-ve të këtij tenderi, “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 2.3.3. a. bëhen ndryshimet si më poshtë:

**Ishte:**

2.3.3. Stafë kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, certifikimet.

a) Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimalisht në 3 muajt e fundit.

***Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:***

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat inxhinierët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Bëhet:**

2.3.3. Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, certifikimet.

c) Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)

• Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimalisht në 3 muajt e fundit.

***Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:***

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat inxhinierët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

III.2.2. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.3. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pikat 4 dhe 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të

*përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
  - a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
  - b) *që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
  - c) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
  - ç) *fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
  - d) *mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.4. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.5. Në rastin konkret për kërkesën e operatorit ekonomik *kërkojmë shtimin e Inxhinierit Mekanik në listën e stafit drejtues teknik*, KPP gjykon se kjo në thelb ka të bëjë me shtim kriteri dhe jo me një pretendim për modifikimin e një kriteri kufizues, diskriminues, i cili do të shkaktonte skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore, si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt ose veprim. Pra operatori ekonomik ankimes duhet të provojë, se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke i dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimes se procedura për fitimin e kontratave publike, do të nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin e parashikuar nga neni 77 i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, për të qenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese dhe specifikimet teknike të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 118 pika 2 gërma “b” të *lex specialis* parashikohet, se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes për këtë fakt nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Pretendimi që autoriteti kontraktor përveç stafit inxhinierik të kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas profileve dhe numrit të caktuar duhet të shtojë edhe staf inxhinierik sipas profileve dhe numrit që ai pretendon, konsiderohet kriter i ri që do të rëndonte pozitën e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkua) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së



prokurimit) të shtojë kriteret e tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik. Për më tepër, referuar pikave të licensës së kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, për kryerjen e punimeve objekt kontrate, nuk ka të parashikuar punime mekanike, të cilat kërkojnë disponimin e një inxhinieri mekanik për realizimin e tyre si dhe nuk ka një detyrim ligjor sektorial, i cili të kushtëzojë prezencën e një profili inxhinierik të caktuar, në rastin konkret profili mekanik, kur nuk ka të parashikuar punime të këtij profili. Si dhe, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), vlerësojmë se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit të sipërcituar. Gjithashtu, KPP referuar preventivit të punimeve gjykon, se stafi inxhinierik i kërkuar, është e drejtë edhe kërkesa e autoritetit kontraktor për staf punonjësish (numër minimal punonjësish) të specializuar/të kualifikuar sipas profileve të caktuara, të cilat duhet të kryejnë punët të specializuara të një kategorie inxhinierike të caktuara, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Nga informacioni i dhënë nga ana e autoritetit kontraktor me Vendim për shqyrtim akese, m nr. 635 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonë me nr. 151/3 prot., datë 01.02.2024, informojnë se “për shtimin e kriterit të sipërmendur sqarojmë se ky kriter ka qenë i vendosur në fillim nga vet AK (njësia e prokurimit) por është shfuqizuar si rezultat i komunikimit dhe sygjërimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila ka cuar edhe në modifikimin dhe hartimin e shtojcës së datës 19.01.2024, të këtij kriteri kualifikimi”. Për këtë arsye, Komisioni iu drejtua me kërkesë për informacin autoritetit kontraktor, për të na vënë në dispozicion komunikimin me Agjencinë e Prokurimit Publik, i cili u dërgua nga ana e autoritetit në komunikimin elektronik me e-mail.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: “2.- Dokumenti “Shtojcë në DST”, Në shtojcën 7 të DST-ve, të këtij tenderi, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 2.3.5, sipas të cilit:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë", e lëshuar nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.

- 5 (pesë) Punonjës specialistë të certifikuar për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017 Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punës si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesis duhet të figurojnë. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtarët që do të kryejnë punimet përkatëse.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Shënim:** Lidhur me standartin EN ISO, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti kontraktor ka kërkuar kualifikime përsa përket Përgjegjësit për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë dhe Saldatorëve, mirëpo nuk ka kërkuar kualifikime për punonjësit që do të merren me Furnizim-Vendosje të zërave në Preventiv që u përkasin “Punimeve elektro-mekanike për matje dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, artikujt nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48:

- Nr. 43, Nr. An, An-R10, F.V Mates smart 6 inch PN64 bar me trasmetim ne distance per nafte

- Nr. 46, Nr. An, An-R11, F.V Saracineske celiku DN = 150 mm , PN 64 bar + Aktuator automaktik

- Nr. 48, Nr. An, An-R12, F.V Sensor Presioni”.

Sipas dokumentit “Specifikime teknike të ndryshuara”, kapitulli 4 “Elementët kryesorë përbërës të sistemit dhe specifikimet teknike të tyre”, faqe 31-34 (faqe dokumentit) përmendet vazhdimisht që produktet duhet të jenë sipas ATEX, ATEX është një direktivë europiane për përcaktimin e pajisjeve që vendosen në zona me rrezikshmëri shpërthimi. Meqënëse kjo procedurë prokurimi nuk kërkon vetëm Furnizim por Furnizim-Vendosje atëhere edhe stafi inxhinierik i operatorit ekonomik duhet të disponojë kualifikim/specializim për njohuritë e këtyre zonave me rrezikshmëri. Argumentojmë se një staf teknik i pakualifikuar në montimin e pajisjeve të tilla ATEX, mund të shkaktojë pasoja të rënda. Për rrjedhojë stafi inxhinierik që do të bëjë vendosjen e artikujve nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48 sipas zërave të preventivit duhet të ketë kualifikim: “Ex F për njohuritë për ndërgjegjësimin zonave me rrezikshmëri ose ekuivalente”. Ky kualifikim për njohuritë e zonave me rrezikshmëri duhet të disponohet si nga inxhinieri Mekanik dhe inxhinieri Mekatronik që do të kryejnë vendosjen e këtyre artikujve. Artikujt nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48 sipas zërave të preventivit nuk janë vetëm furnizim por Furnizim-Vendosje dhe për këtë arsye operatori ekonomik në mënyrë që të realizojë punimet sipas preventiviit në zërin “Punime elektro-mekanike për matje dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, atëhere duhet të disponojë edhe

-Inxhinier Mekanik 1 (një),

-Inxhinier Mekatronik 1 (një),

Për më tepër, për vendosje e zërave në preventiv që u përkasin “Punime elektro-mekanike për matje dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, artikujt nr. 43, nr. 46 dhe nr. 48, të cilat janë pajisje që do të duhet të konfigurohen për të transmetuar apo ndërvepruar me një sistem kontrolli, atëhere inxhinieri mekatronik duhet të disponojë diplomë Master i Shkencave

Elektrike Profili Automatizimi i Industrisë. Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktor të bëjë ndryshimet e mëposhtme:

**Është:**

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e leshuar nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.
- 5 (pese) Punonjës specialistë të certifikuar per punime speciale te saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017 Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesit duhet të figurojnë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet perkatese.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Shënim:** Lidhur me standartin EN ISO, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**TË BËHET:**

2.3.5.- Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e leshuar nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.
- 5 (pese) Punonjës specialistë të certifikuar per punime speciale te saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesit duhet të figurojnë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet perkatese.

- **1 (një) Punonjës të disponojë diplomë: Master i Shkencave Elektrike Profili Automatizimi i Industrisë.**
- **2 (dy) Punonjës përkatësisht Inxhinier mekanik dhe inxhinier mekatronik të disponojnë kualifikim: Ex F për njohuritë për ndërgjegjësimin zonave me rrezikshmëri ose ekuivalent”. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesit duhet të figurojnë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve.**

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Shënim:** Lidhur me standartin EN ISO, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën e datës 19.01.2024 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, 2.3.5. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Në Shtojcën 7 të DST-ve të këtij tenderi, “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” pika 2.3.5. bëhen ndryshimet si më poshtë:

**Ishte:**

1.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si “Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.**
- **1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, e lëshuar nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Ne rast**

se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.

- 5 (pese) Punonjës specialistë të certifikuar per punime speciale te saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017 Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesit duhet të figurojnë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet perkatese.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

### **Bëhet:**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e leshuar nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.
- 5 (pese) Punonjës specialistë të certifikuar per punime speciale te saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017 Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesit duhet të figurojnë. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet perkatese.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Shënim:** Lidhur me standartin EN ISO, do të pranohet edhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të komformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

III.3.2. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.3.3. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pikat 4 dhe 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “4. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
  - a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
  - b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
  - c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
  - ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
  - d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.4. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.3.5. Në rastin konkret, për kërkesën e operatorit ekonomik *duhet të disponohet inxhinieri Mekanik dhe inxhinieri Mekatronik; 1 (një) Punonjës të disponojë diplomë: Master i Shkencave Elektrike Profili Automatizimi i Industrisë; 2 (dy) Puonjës përkatësisht Inxhinier mekanik dhe inxhinier mekatronik të disponojnë kualifikim: Ex F për njohuritë për ndërgjegjësimin zonave me rrezikshmëri ose ekuivalent*”. KPP gjykon se kjo në thelb ka të bëjë me shtim kriteri dhe jo me një pretendim për modifikimin e një kriteri kufizues, diskriminues, i cili do të shkaktonte skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore, si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriteve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt ose veprim. Pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë, se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriteve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke i dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedura për fitimin e kontratave publike, do të nënshtrohet kushteve specifike (kriteve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin e parashikuar nga neni 77 i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, për të qenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese dhe specifikimet teknike të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisimit të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 118 pika 2 gërma “b” të *lex specialis* parashikohet, se ndër

kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes për këtë fakt nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Pretendimi që autoriteti kontraktor përveç stafit inxhinierik të kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas profileve dhe numrit të caktuar duhet të shtojë edhe staf inxhinierik të kualifikuar sipas profileve dhe numrit që ai pretendon, konsiderohet kriter i ri që do të rëndonte pozitivisht e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik. Për më tepër, referuar pikave të licensës së kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, për kryerjen e punimeve objekt kontrate, nuk ka të parashikuar punime mekanike, të cilat kërkojnë disponimin e një inxhinieri mekanik dhe mekatronik, për realizimin e tyre si dhe nuk ka një detyrim ligjor sektorial, i cili të kushtëzojë prezencën e një profili inxhinierik të caktuar, në rastin konkret profili mekanik dhe mekatronik, kur nuk ka të parashikuar punime të këtij profili.

Gjatë seancës dëgjimore, iu la si detyrë operatorit ekonomik ankimes, për paraqitjen e direktivës për të mbështetur pretendimin e tij pasi barra e provës mbi argumentimin e shtimit të kriteret kualifikues, i përket operatorit ekonomik ankimes. Në informacionin shtesë të dërguar me nr. 109 prot., datë 19.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 151/5 prot., datë 19.02.2024, ankiuesi ka dërguar informacionin e kërkuar, të noterizuar me origjinalin me Nr. 279 Rep., datë 19.02.2024 dokumentin “Direktiva ATEX 1999/92/EC, dhe të përkthyer me Nr. 280 Rep., datë 19.02.2024. Pretendimi i operatorit ekonomik “VIBTIS” SHPK bazohet mbi Direktivën Europiane 1999/92/CE për atmosferat shpërthyes, Shtojca 2, Kapitulli 1, masat Organizative, Paragrafi 1.1, Trajnimi i Punëtorëve, Punëdhënësi duhet t’u sigurojë atyre që punojnë në vende ku mund të shfaqen atmosfera shpërthyes trajnim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për mbrotjen nga shpërthimi. Meqenëse kjo procedurë prokurimi kërkon furnizim vendosje atëhere dhe stafi inxhinierik duhet të disponojë kualifikim/specializim për njohuritë e këtyre zonave me rrezikshëri shpërthimi sipas direktivës së Bashkimit Europian për të parandaluar shpërthime të cilat mund të shkojnë nga dëme materiale, në humbje jete. Për sa më sipër, pretenduar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni sqaron se, në përputhje me Direktivën 1999/92/CE e sipërcituar, e cila parashikon se punëdhënësi duhet t’i sigurojë trajnim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për mbrotjen nga shpërthimi, por jo detyrimisht të jenë të kualifikuar apo certifikuar me dëshmi kualifikimi “Ex F për njohurit për ndërgjegjësimin e zonave me rrezikshmëri” ose ekuivalent, siç pretendon ankimesi. Gjithashtu, ankimesi nuk ka paraqitur asnjë argument nëse ka apo jo një detyrim ligjor në përputhje me ligjet në fuqi në RSH ose me cfarë parashikon standardi në mënyrë detyruesë në lidhje me kapacitetin e profilit të ekspertëve të cilët do të kryejnë punimet e kësaj kontrate, pasi në përfundim, barra e provës



mbi argumentimin e shtimit të kriteret kualifikues, i përket operatorit ekonomik ankimes. Pasi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në stafin e punonjësve të kualifikuar edhe 1 (një) person me certifikatë “Personi i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” është një profesionist, i marrë në punë nga punëdhënësi dhe i caktuar për të kryer detyra, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, në përputhje me ligjin nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, seksioni ANEKSI VI PËRMBAJTJA MINIMALE E PLANIT TË SIGURISË NË KANTIERET E PËRKOHSHME E TË LËVIZSHME, Seksioni 2 - Përmbajtja minimale e PSK në lidhje me zonën e kantierit, organizimit të kantierit dhe punimeve. 1. Në lidhje me zonën e kantierit, PSK përmban analizën e elementëve kryesorë në lidhje me shtresat nëntokësore, burime ujore, mole, pemë, punime të ndërfitura ose mbi të cilët duhet ndërhyrë, infrastruktura, ndër të cilat, rrugë, linja hekurudhore, rrjeti ujqor, aeroporte, ndërtesa që kërkojnë kujdes të veçantë, si shkollat, spitalet, shtëpitë e pushimit për moshat e thyera, banesa; linjat ajrore dhe tubacionet e nëndheshme të shërbimeve, kantiere të tjera ose instalime për prodhim; qarkullimi, zhurma, pluhurat, fibra, tymra, avuj, gaze, erëra ose ndotës të tjerë të ajrit, rënien e materialeve nga lartësitë. Në lidhje me elementet e mësipërme në PSK duhet të analizohen përkatësisht: a) karakteristikat e zonës së kantierit; b) prania a mundshme e faktorëve të jashtëm që sjellin rrezik për kantierin; c) rreziqe të mundshme që shkaktohen nga punimet në kantier në zonat rreth tyre. 2. Në lidhje me organizimin e kantierit, PSK përmban dhe elementet që vijojnë: a) mënyrat e mundshme për hyrjen e mjeteve të furnizimit të materialeve; b) pozicionin e impianteve të kantierit; c) pozicionin e zonave të ngarkim - shkarkimit; d) zonat e depozitimit të mjeteve dhe të depozitimit të materialeve dhe të mbeturinave; e) zonat e mundshme të depozitimit të materialeve me rrezik zjarri ose eksplozim. Për më tepër, në seancë dëgjimore, në lidhje me këtë pretendim të ankimesit, përfaqësuesi i autoriteti kontraktor, i cili është edhe projektuesi i projektit në fjalë pranoi se: “Pikë së pari, operatori ekonomik duhet të jetë i lincensuar sipas ligjit dhe VKM shqiptare, licensimin për punimet në ndërtim. Kërkesa e profilit të inxhinierit në këtë rast, është dhënë një minimum, por nëse ofertuesi ka një profil inxhinierik më të mirë dhe plotëson dy nga kërkesat dhe ka një certifikim më tepër, nuk përbën kufizim, por është një avantazh më shumë në konkurim. Se këtu nuk kemi kufizim, nga sa është thënë nga autoriteti nga rishikimi i shtojcës, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e APP, sipas së cilës është hequr inxhinieri mekanik por që është shtuar inxhinieri elektronik, ankimesi ka kërkuar inxhinier mekatronik, që është një profil midis mekanikës dhe elektronikës, në përshtajje me teknologjinë e re, është kërkuar një person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, që për legjilacionin shqiptar i bie që t’i mbulojë të gjitha llojet e punimeve të rrezikshmë, që mund të ketë rrezikshmëri dhe siguri në punë, dhe normalisht të kenë licensat përkatëse dhe kaq është e mjaftueshme, nëse ka një certifikim që është jashtë kësaj, që është i veçantë është një plus për ankimesin, por nëse do të vendosej do të krijonte kufizim të ofertuesëve. Nëse operatori ekonomik, ka licensat përkatëse, ka inxhinierët përkatës, dhe ka ekspert të shëndetit dhe sigursë në punë, është e mjaftueshme për të ekzekutuar kontratën. Autoriteti kontraktor ka parashikuar edhe kërkesën e pikës për N.P - 7 D Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, për të ekzekutuar zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, si dhe argumentuar se vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Për sa më sipër parashtruar dhe trajtuar në këtë seancë dëgjimore, KPP referuar edhe preventivit të punimeve gjykon, se përveç stafit inxhinierik të kërkuar sipas profilit të punimeve, është në të drejtën e plotë të autoritetit

kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: “3.- Dokumenti “DST-Zëvendësim tubacioni” ; “Kriteret e veçanta të kualifikimit: 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.3. shkronja b) sipas të cilit:

b). Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, minimalisht inxhinieret si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit në të cilat inxhinieret e sipërpermendur duhet të figurojnë.

Autoriteti kontraktues nuk ka vlerësuar drejtë kërkesat që duhet të plotësojë operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, sepse ky projekt nuk mund të zbatohet vetëm me një inxhinier hidroteknik dhe 1 inxhinier elektronik. Zërat e preventivit tek seksioni i “Punime elektro-mekanike për majte dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, përmbajnë artikujt:

- Nr. 43, Nr. An, An-R10, F.V Mates smart 6 inch PN64 bar me trasmetim në distance për naftë
- Nr. 46, Nr. An, An-R11, F.V Saracineske celiku DN = 150 mm , PN 64 bar + Aktuator automatik
- Nr. 48, Nr. An, An-R12, F.V Sensor Presioni”.

Këto artikuj nuk janë vetëm Furnizim por Furnizi-vendosje dhe për këtë arsye operatori ekonomik në mënyrë që të realizojë punimet sipas preventivit në zërin “Punime elektro-mekanike për majte dhe monitorimin e prurjeve në linjë”, atëherë duhet të disponojë edhe:

-Inxhinier Mekanik 1 (një);

-Inxhinier Mekatronik 1 (një). Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktor që të marrë parasysh këtë kërkesë dhe të modifikojë të dhënat në DST si më poshtë:

**ËSHTË:**

b). Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, minimalisht inxhinieret si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit te larte.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit ne te cilat inxhinieret e siperpermendur duhet te figurojne.

**TË BËHET:**

b). Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të përfshirë ne licensën e shoqerisë, minimalisht inxhinieret si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)
- **Inxhinier Mekanik 1 (një)**
- **inxhinier Mekatronik 1 (një)**

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit te larte.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit ne te cilat inxhinieret e siperpermendur duhet te figurojne.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, “kriteret e veçanta te kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, 2.3.3 b). autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

b) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të përfshirë ne licensën e shoqerisë, minimalisht inxhinieret si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)

**Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit te larte.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten muajin e fundit ne te cilat inxhinieret e siperpermendur duhet te figurojne.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

III.4.2. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.3. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pikat 4 dhe 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

- 6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
  - a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
  - b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose
  - c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
  - ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
  - d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.4.4. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.5. Në rastin konkret për kërkesën e operatorit ekonomik duhet të disponohet inxhinieri Mekanik dhe inxhinieri Mekanik. KPP gjykon se kjo në thelb ka të bëjë me shtim kriteri dhe jo me një pretendim për modifikimin e një kriteri kufizues, diskriminues, i cili do të shkaktonte skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e

prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore, si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt ose veprim. Pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë, se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke i dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedura për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin e parashikuar nga neni 77 i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, për të qenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, në datën 19.12.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. **REF-91395-12-18-2023**, me objekt **“Zëvendësim i pjesshëm i tubacionit magjstral Ø 6” nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje**” me fond limit 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a. Ndërsa, në datën 19.01.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojca me ndryshimet përkatëse në lidhje me procedurën e sipërcituar. Në datën 23.01.2024 është depozituar me anë të shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “VIBTIS” Shpk me nr. 151/2024 prot., datë 23.01.2024, **duke kërkuar modifikimin e shtojcës** së dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Pra, referuar dispozitës ligjore të prokurimit, ankimuesi e ka patur momentin e vet procedural për t’u ankuar mbi kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentat e tenderit, dhe nuk legjitimohet të paraqesë pretendime mbi modifikimin e tyre, pasi në fazën aktuale ku është procedura objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën me ndryshimet përkatëse më datë 19.01.2024, për të cilat ankimuesi ka parashtruar pretendimet e tij me anë të formularit të ankesës më datë 23.01.2024.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: “**II-** Mungesë në dokumentacion: Autoriteti kontraktor ka publikuar një procedurë prokurimi me mangësi në dokumentacionin e projektit. Një projekt i detajuar i kryer nga një kompani me eksperiencë në sektorin e tubacioneve për naftë bruto, si pjesë të projektit detajuar duhet të kishte dorëzuar shtesë edhe listën e mëposhtme të dokumentave:

- Diagrama e tubacionit dhe instrumentave (P&ID);
- Llogaritjet e sforcimeve mekanike të tubacionit;
- Isometria e Linjës së tubacionit;
- Skema elektrike detajuar e lidhje të pajisjeve elektro-mekanike;
- Diagrama dhe vizatimi e Panelit të Kontrollit për pajisjet elektro-mekanike;
- Matrica Shkak-Pasojë;
- Klasifikimi i zonave të rrezikshmërisë ATEX;
- Sistemi i ndalimit emergjent;
- Llogaritjet e Përmasimit të Kalimatësit Coriolis;
- Lista e sinjaleve hyrëse/dalëse (I/O) dhe Herat e Alarmeve të sinjaleve

Të gjitha vërejtjet më lart janë demonstrim i faktit që projektuesi i caktuar për hartimin e këtij projekti nuk ka eksperiencë të mëparshme projektimi tubacioni naftë bruto, nuk ka dijenitë e duhura për specifikimin e pajisjeve elektro-mekanike dhe nuk ka njohuritë e duhura përsa i përket klasifikimit të zonave ATEX. Integriteti i dokumentacionit teknik të projektit është i cënuar. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor po gabon duke publikuar një procedurë prokurimi bazuar mbi një projekt i cili është i pa saktë. Në mënyrë të menjëhershme pas vënies në dijeni të këtij ankimi, autoriteti kontraktor duhet të ndërhyjë për modifikimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit dhe të hartojë projektin e saktë bazuar në standarde dhe normativat e duhura për projektimin e tubacioneve të transportimit naftës bruto. Modifikimi i specifikimeve teknike, është i domosdoshëm për shkak të shkeljeve të rënda teknike në dokumentet teknike, të cilat nëse nuk korrigjohen do të sjellin dëme ekonomike, mjedisore dhe njerëzore. Në këto kushte, mos veprimi nga ana e autoritetit kontraktor, sjell pasoja, për të cilat mbahet përgjegjësi administrative dhe ligjore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në sistemin e prokurimit elektronik, autoriteti kontraktor, përveç dokumentave standarde të tenderit, shtojcës, ka ngarkuar edhe dokumentacion teknik, si më poshtë:

- projekti teknik pdf;
- Relacion teknik pdf;
- Specifikime teknike pdf;
- Relacion topografik pdf;
- Projekti elektrik pdf;
- Relacion elektrik pdf;
- Metodologjia e ndërtimit pdf;
- Relacion gjeologo-inxhinierik pdf;
- Plan rievimi topografik pdf;
- Planimetria e përgjithshme pdf;
- Grafiku i punimeve pdf;
- Preventivi pa cmime pdf;
- Relacion teknik i ndryshuar pdf;

- *Specifikime teknike të ndryshuara pdf;*
- *Procesverbal miratimi të kriterëve ëord;*
- *DST ëord;*
- *Shtojcë në DST ëord;*

III.5.2. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.5.3. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 4. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

III.5.4. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.5.5. Në rastin konkret për kërkesën e operatorit ekonomik *duhet të disponohet list dokumentacioni shtesë për projektin.* KPP gjykon se kjo në thelb ka të bëjë me shtim kriteri dhe jo me një pretendim për modifikimin e një kriteri kufizues (*dokument teknik në lidhje me projektin*), diskriminues, i cili do të shkaktonte skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore, si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. *Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë*

*të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt ose veprim. Pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë, se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke i dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedura për fitimin e kontratave publike, do të nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin e parashikuar nga neni 77 i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, për të qenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, dokumentacionin teknik të nevojshëm për zbatimin e projektit si dhe specifikimet teknike të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese, dokumentacionin teknik për zbatimin e projektit si dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 118 pika 2 gërma “b” të *lex specialis* parashikohet, se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues për këtë fakt nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji, apo dokumentacion teknik jo konform ligjit sektorial), por mbi shtimin e kriterëve apo dokumentave teknik për zbatimin e projektit, kualifikuese në një procedurë prokurimi. Pretendimi që autoriteti kontraktor përveç dokumentacionit teknik të dorëzuar për zbatimin e projektit të vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor por duhet të shtojë edhe dokumentacion shtesë teknik për zbatimin e projektit që ai pretendon, konsiderohet si kriter i ri që do të rëndonte pozitën e operatorëve



ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese apo dokumentacion teknik të nevosjhmë, në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura, dokumentacioni teknik i vënë në dispozicion nga vet autoriteti kontraktor) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi dhe ato sektoriale, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese apo dokumentacion teknik shtesë, për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Ky pretendim u trajtua edhe gjatë seancës dëgjimore. Në lidhje me këtë pikë, vetë operatori ekonomik ankimues sqaroi se, dokumentacioni është kërkuar në sensin e sqarimit, që në fazën e dytë të instalimeve, në projekte të kësaj fushe, janë pjesë e dokumentacionit teknik në fazën e instalimeve, por jo në fazën e ofertimit, pasi nuk cënon ose kufizon konkurrencën në momentin procedural ku është procedura e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: “4.- Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 22 dhe 23 e dokumentit, kapitulli 6, paragrafi 6.4 Tubi Celikut, sipas të cilit:

“.....Përbëria kimike (në %) e materialit të tubove duhte të jetë: Karboni (C) jo më tepër se 0.24 dhe jo më pak se 0.17, Mangani (Mn) të mos jetë më tepër se 1.15 por jo më pak se Bakri (Cu) të mos e kalojë vlerën 0.08, Fosfori (P) të mos jetë më tepër se 0.025, Squfuri (S) të mos jetë më tepër se 0.026.

Vetitë mekaniko-fizike të ubove duhet të jenë: Forca elastike të jetë minimalisht 434 N/mm<sup>2</sup>. Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 270Mpa.

.....

*Të dhënat kryesore të tubit*

*Standardi; API 5L ose ekuivalent*

*Grada e celikut: A , A25*

*Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 172 Mpa*

*Diametri i jashtëm: 6’’ (150mm)*

*Spesori: 6.35 mm*

*Gjatësia: 6-12m*

.....

*Kërkesat teknike të kërkuara nuk janë në përputhje me standardin API 5L apo me ekuivalentët e tij.*

**Së pari:** tek paragrafi për të dhënat kryesore të Tubit dimensionioi i tubit është kërkuar diamtri i jashtëm 6in (150mm). Kjo kërkesë nuk përputhet me API 5L, i cili për dimensionet e tubove referon standardin ASME B36.10M, ku në faqen 5, Tabela 1, përcakton diamtrin nominal 6in (150mm) ndërsa diamtri i jashtëm 6.625in (168.3mm). Më poshtë gjeni tabelën e përkthyer nga standardi ASME B36.10M për referencë:

Dimensionet dhe peshat e tubove celiku te farketuar te salduara dhe pa saldim									
Njesi amerikane				Identifikimi [Standard (STD), Shume I forte (XS), Dy here me I forte (XXS)]	Nr. Skedulit	DN	Njesi SI		
NPS	Diametri I jashtem [in.]	Spesori [in]	Pesha I Fundi I sheshte [lb/ft]				Diametri I jashtem [mm]	Spesori [mm]	Masa e Fundi I sheshte [kg/m]
3 1/2	4.000	0.226	9.12	STD	40	90	101.6	5.74	13.57
3 1/2	4.000	0.250	10.02	...	...	90	101.6	6.35	14.92
3 1/2	4.000	0.281	11.17	...	...	90	101.6	7.14	16.63
3 1/2	4.000	0.318	12.52	XS	80	90	101.6	8.08	18.64
4	4.500	0.083	3.92	...	5	100	114.3	2.11	5.84
4	4.500	0.109	5.12	...	...	100	114.3	2.77	7.62
4	4.500	0.120	5.62	...	10	100	114.3	3.05	8.37
4	4.500	0.125	5.85	...	...	100	114.3	3.18	8.71
4	4.500	0.141	6.57	...	...	100	114.3	3.58	9.78
4	4.500	0.156	7.24	...	...	100	114.3	3.96	10.78
4	4.500	0.172	7.96	...	...	100	114.3	4.37	11.85
4	4.500	0.188	8.67	...	30	100	114.3	4.78	12.91
4	4.500	0.203	9.32	...	...	100	114.3	5.16	13.89
4	4.500	0.219	10.02	...	...	100	114.3	5.56	14.91
4	4.500	0.237	10.80	STD	40	100	114.3	6.02	16.08
4	4.500	0.250	11.36	...	...	100	114.3	6.35	16.91
4	4.500	0.281	12.67	...	...	100	114.3	7.14	18.87
4	4.500	0.312	13.97	...	...	100	114.3	7.92	20.78
4	4.500	0.337	15.00	XS	80	100	114.3	8.56	22.32
4	4.500	0.438	19.02	...	120	100	114.3	11.13	28.32
4	4.500	0.531	22.53	...	160	100	114.3	13.49	33.54
4	4.500	0.674	27.57	XXS	...	100	114.3	17.12	41.03
5	5.563	0.083	4.86	...	...	125	114.3	2.11	7.24
5	5.563	0.109	6.36	...	5	125	114.3	2.77	9.46
5	5.563	0.125	7.27	...	...	125	114.3	3.18	10.83
5	5.563	0.134	7.78	...	10	125	114.3	3.40	11.56
5	5.563	0.156	9.02	...	...	125	114.3	3.96	13.41
5	5.563	0.188	10.80	...	...	125	114.3	4.78	16.09
5	5.563	0.219	12.51	...	...	125	114.3	5.56	18.61
5	5.563	0.258	14.63	STD	40	125	114.3	6.55	21.77
5	5.563	0.281	15.87	...	...	125	114.3	7.14	23.62
5	5.563	0.312	17.51	...	...	125	114.3	7.92	26.05
5	5.563	0.344	19.19	...	...	125	114.3	8.74	28.57
5	5.563	0.375	20.80	XS	80	125	114.3	9.53	30.97
5	5.563	0.500	27.06	...	120	125	114.3	12.70	40.28
5	5.563	0.625	32.99	...	160	125	114.3	15.88	49.12
5	5.563	0.750	38.59	XXS	...	125	114.3	19.05	57.43
6	6.625	0.083	5.80	...	...	150	168.3	2.11	8.65
6	6.625	0.109	7.59	...	5	150	168.3	2.77	11.31
6	6.625	0.125	8.69	...	...	150	168.3	3.18	12.95
6	6.625	0.134	9.30	...	10	150	168.3	3.40	13.83
6	6.625	0.141	9.77	...	...	150	168.3	3.58	14.54
6	6.625	0.156	10.79	...	...	150	168.3	3.96	16.05
6	6.625	0.172	11.87	...	...	150	168.3	4.37	17.67
6	6.625	0.188	12.94	...	...	150	168.3	4.78	19.28
6	6.625	0.203	13.94	...	...	150	168.3	5.16	20.76
6	6.625	0.219	15.00	...	...	150	168.3	5.56	22.31
6	6.625	0.250	17.04	...	...	150	168.3	6.35	25.36
6	6.625	0.280	18.99	STD	10	150	168.3	7.11	28.26

*Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e gartë të Dimensionit të jashtëm kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Spcifikimet teknike, pika 3.*

*Së dyti, tek paragrafi për të dhënat kryesore të tubit është kërkuar grada A, A 25 sipas API 5L. Kjo kërkesë nuk përputhet me kërkesat e standardit API 5L ku në faqen 21, tabela 2, është përcaktuar që grada A25 është e limituar për tubo me diametër më të vogël se 141.3mm (5.563in) [D≤141.3mm (5.563in)]. Ju lutemi të gjeni më poshtë tabelën e referencës të përkthyer nga standardi API 5L:*

*Tabela 2-Proceset e prodhimit të pranueshme dhe PSL*

Tabela2- Proceset e Prodhimit te Pranueshme dhe PSL

Lloji I tubos ose I fundit te tubos	Tubo Grade PSL 1					Tubo Grade PSL 2		
	L175 ose A25 <sup>b</sup>	L175P ose A25P <sup>b</sup>	L210 ose A	L245 ose B	L290 ose X42 deri ne L485 ose X70	L245 ose B deri ne L555 ose X80	>L555 ose X80 deri ne L690 ose X100	>L690 ose X100 deri ne L830
								ose X120
Lloji I tubos								
SMLS	X	X	X	X	X	X	X	-
CW	X	X	-	-	-	-	-	-
LFW	X	-	X	X	X	-	-	-
HFW	X	-	X	X	X	X	-	-
LW	-	-	-	-	X	-	-	-
SAWL <sup>c</sup>	-	-	X	X	X	X	X	X
SAWH <sup>d</sup>	-	-	X	X	X	X	X	X
COWL <sup>c</sup>	-	-	X	X	X	X	-	-
COWH <sup>d</sup>	-	-	X	X	X	X	-	-
Lloji I fundit te tubos								
Fund me trashje <sup>e</sup>	X	-	X	X	X	-	-	-
Fund I sheshte	X	-	X	X	X	X	X	X
Fund I sheshte per manikota speciale	X	-	X	X	-	-	-	-
Fund me fileta <sup>f</sup>	X	X	X	X	-	-	-	-
<p>a Grada ndermjetese jane te mundshme nese dakortesohen, por te limituara ne grada me te larta se L290 ose X42</p> <p>b Gradat L175, L175P, A25 dhe A25P jane te limituara deri ne tubo me D ≤ 141.3 mm (5.563 in)</p> <p>c Tubot dy tegele saldimi jane te mundshme nese dakortesohet, por te limituara ne tubo me D ≥ 914 mm (36.000 in)</p> <p>d Tubo me tegel saldimi spirale jane te limituara ne tubo me D ≥ 114.3mm (4.500 in)</p> <p>e Tubo me funde me trashje jane te limituara ne tubo me D ≤ 219.1 mm (8.625 in) dhe t ≤ 3.6 mm (0.141 in)</p> <p>f Tubot me funde me fileta jane te limituara ne SMLS dhe tubo me tegel saldimi gjatesor me D ≤ 508 mm (20.000 in)</p>								

Projektuesi ka specifikuar një standard në kundërshtim me të dhënat kryesore objekt prokurimi, i cili është diametri i jashtëm i tubacionit që është 168.3mm. Pra operatori ekonomik nuk duhet ti jepet e drejta të marri pjesë në procedurë me një tube celiku me diametër 168.3mm dhe gradë celiku A25, sepse nuk e lejon standradi referencës. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të Gradës Celikut kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Specifikimet teknike, pika 3.

Së treti, tek paragrafi për të dhënat kryesore të tubit është përzgjedhur grada A, A25 të cilat janë grada inferiore përkundrejt gradës B të API 5L. Përbërja kimike celikut Grada A sipas API 5L e bën më të presdispozuar për korrozion të parakohshëm kundrejt gradës B për shkak të përqindjes së karbonit, kjo duke marrë parasysh dhe përmbajtjen e lartë të H2S të cituar në Relacionin teknik të ndryshuar pdf. Gjithashtu, Grada B e standardit API 5L ka një limit më të lartë të forcës elastike dhe qëndrueshmërisë maksimale cka e bën më rezistente ndaj sforcimeve mekanike që mund të shkaktojnë carje të tubit. Prandaj projektuesi në vend të lejontë Gradën A dhe Gradën A25 (gradë inferiore ndaj Gradës A dhe e papërshtatshme për diametrin e tubit

sipas parashtrimit më lart) si të përshtatshme, do të duhej të specifikonte duke lejuar një gradë më të mirë se Grada A pra: Grada A ose Gradën B ose ekuivalent”.

Së katërti, janë dhënë dy vlera për kufirin minimal të rrjedhshmërisë. në faqen 22 kërkohet kufiri i rrjedhshmërisë minimalisht 270Mpa, ndërsa në faqen 23, paragrafi të dhënat kryesore të tubit, kërkohet që kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 172Mpa. Për tu theksuar më tej që të dyja këto nuk përputhen me kërkesat e standardit API 5L, i cili parashikon kufirin e rrjedhshmërisë për Gradën A të jetë minimalisht 210Mpa. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të vetisë mekanike-fizike kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Spcifikimet teknike, pika 3.

Së pesti, tek paragrafi për kërkesat e përbërjes kimike të tubit nuk janë në përputhje me standardin API 5L sipas tabelës 1. Përbërjet kimike sipas API 5L paraqitur më poshtë:

tabela 1 –Përbërjet kimike API 5L

Tabela 1 - Perberjet kimike sipas API 5L

Standardi Parametrat	Specifikimet teknike sipas dokumentit “Specifikimet Teknike te ndryshuara.pdf”	Krahasuar me	Specifikimet teknike sipas standartit API 5L
	Grada A,		Grada A
Karboni (C) [%]	0.17 deri ne0.24		Max 0.22
Mangani (Mn)[%]	0.44 deri ne 1.15		Max 0.90
Bakri (Cu)[%]	Max 0.08		Max 0.5
Fosfori (P)[%]	Max 0.025		Max 0.03
Squfur (S)[%]	Max 0.026		Max 0.03

Projektuesi ka specifikuar diapaznone të përbërjes kimike tubit në kundërshtim me përcaktimet e standardid referencë API 5L Grada A. Projektuesi nuk mundet të specifikojë të dhëna të tilla të përbërjes kimike pa u bazuar në standard. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e vetive kimike kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Spcifikimet teknike, pika 3.

Së gjashti, tek paragrafi për të dhënat kryesore të tubit është përmendur standardi API 5L ose ekuivalent. Atëhere ne kemi marrë në analizë standardin API 5L dhe standardet ekuivalente (EN 10216-2 dhe ASTM A106M) të tij përse përket përbërjes kimike dhe vetive mekanike të grada A kërkuar dhe të gradës B. Më poshtë gjeni analizën e detajuar krahasimore midis specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentin “Specifikime teknike të ndryshuara pdf” dhe specifikimeve teknike të referencës:

Standardi Parametrat	Specifikimet teknike sipas dokumentit “Specifikimet Teknike te ndryshuara.pdf” Grada A	Krahasuar me	Specifikimet teknike sipas standartit API 5L		Specifikimet teknike sipas standartit EN 10216-2	Specifikimet teknike sipas standartit ASTM 106M	
			Grada A	Grada B	P265GH	Grada A	Grada B
Karboni (C) [%]	0.17 deri ne0.24		Max 0.22	Max 0.28	Max 0.2	Max 0.25	Max 0.30
Mangani (Mn)[%]	0.44 deri ne 1.15		Max 0.90	Max 1.2	Max 1.4	0.27 deri ne 0.93	0.29-1.06
Bakri (Cu)[%]	Max 0.08		Max 0.5	Max 0.5	Max 0.3	Max 0.4	Max 0.4
Fosfori (P)[%]	Max 0.025		Max 0.03	Max 0.03	Max 0.025	Max 0.035	Max 0.035
Squfur (S)[%]	Max 0.026		Max 0.03	Max 0.03	Max 0.02	Max 0.035	Max 0.035
Forca elastike [N/mm2]	Min 434		Min 335	Min 415	410 deri ne 570	Min 330	Min 415
Kufiri i rrjedhshmerise [Mpa]	Min 270		Min 210	Min 245	Min 265	Min 205	Min 240

Projektuesi ka specifikuar diapazone të përbërjes kimike dhe të vetive mekaniko-fizike tubit në kundërshtim me përcaktimet e standardit referencë API 5L Grada A dhe të standardeve ekuivalente. Projektuesi nuk mundet të specifikojë të dhëna të tilla të përbërjes kimike dhe të vetive mekaniko-fizike pa u bazuar në standard. Në rastet kur standardi përcakton vetëm kufirin maksimal, atëherë projektuesi nuk mund të vendosi diapazon edhe për kufirin minimal për aq kohë sa standardi përcakton vetëm kufij maksimal. Në këto raste projektuesi duhet të marrë për bazë vetëm kufirin më të lartë maksimal që lejon standardi i përcaktuar apo ekuivalentet e tij. Në rastet kur standardi përcakton vetëm kufij minimal, atëherë projektuesi nuk mund të përcaktojë një kufi minimal të ndryshëm nga standardi përcaktuar apo ekuivalent i tij. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e përbërjes kimike dhe të vetive mekaniko-fizike kërkuar të tubit në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik, neni 36 Specifikimet teknike, pika 3. Duke u bazuar në pikat e mësipërme, ne si operator ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në këtë tender, kërkojmë të bëhen ndryshimet e mëposhtme në dokumentin “Specifikime teknike të ndryshuar pdf.”.

Së pari, paragrafi:

**Është:**

“.....Përbëria kimike (në %) e materialit të tubove duhte të jetë: Karboni (C) jo më tepër se 0.24 dhe jo më pak se 0.17, Mangani (Mn) të mos jetë më tepër se 1.15 por jo më pak se Bakri (Cu) të mos e kalojë vlerën 0.08, Fosfori (P) të mos jetë më tepër se 0.025, Squfuri (S) të mos jetë më tepër se 0.026.

Vetitë mekaniko-fizike të ubove duhet të jenë: Forca elastike të jetë minimalisht 434 N/mm<sup>2</sup>. Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 270 Mpa.

**Të bëhet:**

“.....Përbëria kimike (në %) e materialit të tubove duhte të jetë: Karboni (C) jo më tepër se 0.3, Mangani (Mn) të mos jetë më tepër se 1.4, Bakri (Cu) të mos e kalojë vlerën 0.5, Fosfori (P) të mos jetë më tepër se 0.035, Squfuri (S) të mos jetë më tepër se 0.035.

Vetitë mekaniko-fizike të ubove duhet të jenë: Forca elastike të jetë minimalisht 330 N/mm<sup>2</sup>. Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 205 Mpa.

Së dyti, paragrafi:

**Është:**

Të dhënat kryesore të tubit

Standardi: API 5L ose ekuivalent

Grada e celikut: A , A25

Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 172 Mpa

Diametri i jashtëm: 6’’ (150mm)

Spesori: 6.35 mm

Gjatësia: 6-12m

**Të bëhet:**

Të dhënat kryesore të tubit

Standardi; API 5L ose ekuivalent

Grada e celikut: Grada A ose Grada B/ ose Ekuivalent

Kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 205 Mpa

Diametri i jashtëm: 6.625in (168.3mm)

Spesori: 6.35 mm, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Dokumentacioni “Specifikimet teknike të ndryshuar, pdf”, i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektornik, nga ana e autoritetit kontraktor, ku citohet:

#### 6.4 TUBI I ÇELIKUT

Tubot duhet të jenë të prodhuara pa tegel saldimi dhe sipas teknologjise së petëzimit dhe ngjeshjes në temperatura shume të larta. Materiali i tubove duhet të jetë në përputhje me nivelin e parë të specifikimeve të produktit, sipas liçensës dhe standardit për prodhimin e tubove të linjës me fund të sheshtë dhe atyre pa tegel saldimi, sipas standartit API 5L ose ekuivalent. Aplikimi i tyre duhet te perdoren per transportin e fluideve (naftes).Tubat e naftes duhet te plotesojne te gjitha kerkesat kimike dhe mekanike sipas standartit API 5L ose ekuivalente,

Përbërja kimike (ne %) e materialit të tubove duhet të jetë :Karboni (C) jo me të tepër se 0.24 dhe jo me pak se 0.17, Mangani (Mn) të mos jetë me tepër se 1.15, por dhe jo më pak se 0.44,Bakri (Cu) të mos e kalojë vlerën 0.08, Fosfori (P) të mos jetë më tepër se 0.025,Squfuri (S) të mos jetë më tepër se 0.026.

Vetitë mekaniko-fizike të tubove duhet të jenë :Forca elastike të jetë minimalisht 434 N/mm<sup>2</sup>. Kufiri i rrjedhshmerise të jetë minimalisht 270 MPa.Zgjatimi relativ i materialit të jetë minimalisht 28%.Tubot duhet të prodhohen dhe lëvrohen në një gjatësi jo më të madhe se 12m. Të jenë të lyera me bojë per të shmangur gërryerjen dhe skajet t'i kenë të izoluar dhe veshur me kapak mbrojtës.Materiali i tubove duhet të jetë në përputhje me direktivat e pajisjeve të presionit, miratuar nga Komiteti European ne vitin 2014, gjithashtu, testimi i kryer për tubot duhet të plotësojë kërkesat e direktives 68 të Komitetit European.

Për vetitë e mësipërme, duhet të paraqiten testet : Analiza e Komponentit Kimik, Vetitë Mekanike, Vetitë Teknike; Test jo destruktiv; Testi hidrostatik.,

Për të vërtetuar cilësinë , duhet te paraqiten çertifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me çelik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe çertifikata e materialit (me markim CE) në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European.

#### Të dhënat kryesore të tubit

Standarti; API 5L ose ekuivalent

Grada e celikut; A,A25

Kufiri i rrjedhshmerise të jetë minimalisht 172 MPa

Diametri i jashtëm :6” (150mm)

Spesori :6.35mm

Gjatesia : 6-12m



Veshja e tubit :Te lyer me boje epokside per të shmangur gërryerjen dhe skajet t'i kenë të izoluar dhe veshur me kapak mbrojtës.

III.6.2. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të

përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e



tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larinë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”**

KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.6.4. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e

prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin “Specifikime teknike të ndryshuara pdf,” pretendon se:

- *dimensioi i tubit është kërkuar diamtri i jashtëm 6in (150mm). Kjo kërkesë nuk përputhet me API 5L, i cili për dimensionet e tubove referon standardin ASME B36.10M, ku në faqen 5, Tabela 1, përcakton diamtrin nominal 6in (150mm) ndërsa diamtri i jashtëm 6.625in (168.3mm). projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të Dimensionit të jashtëm kërkuar të tubit;*

- *është kërkuar grada A, A 25 sipas API 5L. Kjo kërkesë nuk përputhet me kërkesat e standardit API 5L ku në faqen 21, tabela 2, është përcaktuar që grada A25 është e limituar për tubo me diametër më të vogël se 141.3mm (5.563in) [ $D \leq 141.3\text{mm}$  (5.563in)]; projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të Gradës Celikut kërkuar të tubit;*

- *janë dhënë dy vlera për kufirin minimal të rrjedhshmërisë. në faqen 22 kërkohet kufiri i rrjedhshmërisë minimalisht 270Mpa, ndërsa në faqen 23, paragrafi të dhënat kryesore të tubit, kërkohet që kufiri i rrjedhshmërisë të jetë minimalisht 172Mpa. Për tu theksuar më tej që të dyja këto nuk përputhen me kërkesat e standardit API 5L, i cili parashikon kufirin e rrjedhshmërisë për Gradën A të jetë minimalisht 210Mpa. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e qartë të vetisë mekanike-fizike kërkuar të tubit;*

- *kërkesat e përbërjes kimike të tubit nuk janë në përputhje me standardin API 5L. Projektuesi ka specifikuar diapaznone të përbërjes kimike tubit në kundërshtim me përcaktimet e standardit referencë API 5L Grada A. Projektuesi nuk mundet të specifikojë të dhëna të tilla të përbërjes kimike pa u bazuar në standard. Pra projektuesi dukshëm ka krijuar konfuzion në përcaktimin e vetive kimike kërkuar të tubit;*

Për shkak të specifikës së procedurës së prokurimit dhe nivelit të ekspertizës së saj dhe kërkesës së operatorit ekonomik ankimues për ekspertizë të posaçme, përpri vijimit më hapa të tjerë proceduriale, ka vendosur të tjërrasi në këtë seancë dëgjimore autoritetin kontraktor dhe operation ekonomik ankimues në lidhje me sqarimin e fakteve dhe rrethanave të ankesës së operatoit ekonomik dhe dëgjimit të autoriteti kontraktor. Konkretisht nga ana e Komisionit pasi u shqyrtua ankesa e ankimuesit është konstatuar se pretendimet që ngren operatori ekonomik ndër të parët është në dokumentin me emërtimin “Specifikime teknike të ndryshuar. pdf”. Në lidhje me këto pretendime, KPP i ftoi palët në procesin administrative me nr. 151 prot, duke zhvilluar një seancë dëgjimore me datë 16.02.2024. Komisioni iu drejtua palëve në këtë seancë nëse ka kërkesa paraprake prej tyre, dhe nuk pati asnjë kërkesë paraprake nga ana e tyre. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua atutoritetit kontraktor, konkretisht projektuesit, i ngarkuar nga autoriteti kontraktor për hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me objektin e prokurimit, mbi mënyrën e hartimit të këtyre specifikimeve teknike. Konkretisht:

Pyetjet drejtuar AK: “Si janë hartuar specifikimet teknike të tubit të celikut objekt prokurimi? Cilat prej metodave të përcaktuara në nenin 36 të ligjit të prokurimit publik është mbështetur autoriteti kontraktor për hartimin e specifikimeve teknike? Në cilin standard kombëtar apo ndërkombëtar jeni bazuar? Cili është standardi i referuar nga ana e autoritetit kontraktor në hartimin e këtij specifikimi teknik? Cfarë është standardi API 5L? A ka vlerësuar autoriteti kontraktor nëse specifikimet teknike plotësohen nga më shumë se një prodhues në treg? A

*përmbush qëllimin dhe funksionalitetin një tub celik për objektin e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor me një diametër të jashtëm, kufi rrjedhshmërie, gradë celiku, përbërje kimike, veti mekanike të ndryshme nga ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, me synim nxitjen e konkurrencës?*

*Përgjigjja e përfaqësuesit i konsulentit të jashtëm, i kontraktuar nga ana e autoritetit kontraktor Albpetrol sha, i cili sqaroi se: “specifikimet teknike të tubit, duke qënë se edhe objekti ka qënë një linjë ekzistuese, pjesërisht i zëvendësuar më parë, për shkak të amortizimit, dhe ne si projektues kemi qënë disi të kufizuar, e cila kishte disa parametra (si diametri, gjatësi), relievi ishte i përcaktuar, dhe të dhënat bazë të tubit që AK kishte përdorur më përpara. Në lidhje me hartimin e kritereve kualifikuese janë hartuar sipas VKM dhe ligjit përkatës, ndërsa specifikimeve teknike tubit dhe llogaritjet janë pjesë e relacionit teknik dhe specifikimeve, Sipas AK, është kërkuar që në detyrën e projektimit të përdoren standardet ASME (amerikane), për linjën e tubit dhe dimensionin e tubit ka qënë apriori i përcaktuar, që ka qënë 6 inch, dhe në bazë të dhënave që kishim nga autoriteti kontraktor të nxirrej një parametër tubi, i cili të kishte karakteristikat minimale (se max variojnë), dhe si kritere të përcaktuara nga ne, ka qënë diametri 6 inch, i cili është bërë një lapsus nga ana jonë, të cilën e pranojmë, nuk është specifikuar se cili diametër është i brendshëm apo i jashtëm. Por që në tabelat e standardit referuar edhe në tabelat ndërkombëtare standardit, sqarohet se cili është dimensionin përkatës, duke qënë se edhe nga detyra e projektimit e kemi diametrin, spesori është llogaritur në bazë të formulës që është dhënë standard ASME por që normalisht ka dhe standard ekuivalente europiane dhe amerikane që janë të ekuivalentuar në Shqipëri por që ne na është kërkuar apriori që të përdorim standard amerikan ASME dhe në bazë të tij janë bërë përllogaritjet.*

*-Në lidhje me spesorin, ka dalë nga tabelat dhe llogaritjet bazë për presionin, llojin e lëngut, karakteristikat bazë të tij.*

*- është përdorur standardi API 5L ose ekuivalent dhe është dhënë Gradë celiku A, A25 por jo e limituar, pasi këto janë të dhëna minimale nga projektuesi, pa kufizuar, në kuptimin që një gradë celiku më e mirë ose më e fortë për diametrin përkatës dhe është dhënë një kufi minimal rrjedhshmërie 172 MPA, që gjendet në tabelat e këtij standardi. Por që operatorët ekonomikë konkurues nuk kufizohen te kjo, në kuptim që, pasi duke plotësuar dimensionin që kërkohet, dhe të japin një kufi rrjedhshmërie më të lartë, do të thotë që nuk kufizohen me këtë sepse ne kemi dhënë një minimum dhe nqs standardi apo prodhuesi do të sjellë një tubacion që ka një kufi rrjedhshmëria që është më i lartë se ky që është dhënë në specifikimet bazë, do të thotë që nuk kemi kufizim në kritere, pasi është një minimum. Grada e celikut mund të jetë edhe mbi Gradën A.*

*-për përbërjen kimike gjithashtu, në standard jepet fashë min/max, specifikat që kemi dhënë ne, në specifikime teknike përfshihen në këtë kufi që kërkon standardi, dhe është diapason nuk është diçka fikse, ideja është që kemi një diapason që është po brenda diapazonit të standardit, kshu që nuk kemi kufizim të kritereve për operatorët ekonomikë konkurues.*

*Komisioni iu drejtua AK: “Çfarë është standardi API 5L? Dhe si konvertohen sipas standardit në specifikimet teknike në lidhje me këto komponentë që operatori ekonomik ankimes kundërshton në këtë procedurë prokurimi me këto specifikime?”*

Përgjigjja e AK: *“siç thashë standardi është amerikan, dhe në këtë standard jepen të dhënat e tubave të celikut, sipas gradës dhe dimensioneve të tyre. Ka tabela përkatëse që japin në varësi të diametrit, gradën e celikut dhe kufijtë minimalë të rrjedhshmërisë dhe elasticitetit. Nga kjo tabelë merren diametrat, parametrat standard të tubacionit, në varësi të asaj se çfarë kërkohet dhe apriori në kemi pas diametrit e tubit, që e kemi patur të përcaktuar, duke dikur se çfarë prurje kemi pasur, relievin, sasinë e lëngut që do pompohet të naftës, dhe duke ditur që tubi ekzistues që autoriteti ka përdorur është i përmasës 6 inch, ne do të përcaktonim një reinxh minimal, për të dhënat bazë, përfshirë edhe anën kimike, e cila përfshihet në diapazonin e këtij standardi. Edhe kufiri i rrjedhshmërisë minimal i cili është marrë për një gradë celiku më të ulët por që nuk do të thotë që e elimiton që operatori ekonomik të sjelli një tub me një gradë celiku më të mirë, me dimension, plotëson edhe kufirin minimal, plotëson edhe kriteret kimike. Mendoj se është e mundur nga prodhues të ndryshëm.*

Pra, në vlerësimin e autoritetit kontraktor, ka më shumë se një prodhues, i cili mund të plotësojë specifikimet teknike, të vendosura nga ana e këtij të fundit.

Pyetje për AK: *“Një tub me parametra të ndryshuar, të përbërjes kimike, të diamtrit të jashtëm, të kufirit të rrjedhshmërisë, të gradës së celikut, vetitë mekanike, të ndryshme sikur ndër pretendohen nga ana e operatorit ekonomik, pra të ketë një diapazon apo një rishikim të specifikimeve teknike a mund ta kryejë qëllimin për të cilën është objekti i procedurës së prokurimit, mund të ndikojë qëllimin e objektit të procedurës së prokurimit, rishikimi i specifikimeve teknike të këtyre mallrave, në përputhje me standardin e vendosur?”*

Kthim përgjigje nga AK: *“Nuk do të ndikojë, e vetjma gjë që mund të themi, mund të jetë më e qartë, duke qenë se operatori ekonomik ka shprehur që ka një paqartësi/konfuzion, mund të jetë më e qartë referuar standardid. Duke qenë sekjo që themi është brenda standardid min dhe nuk kufizon, mund të saktësojmë diamtrin siç e thamë që është një lapsus, mund të themi që grada e celikut mund të jetë mbi A, do të jetë më e qartë për operatorët ekonomikë, por nuk do të ndryshojë gjë, pasi në fund tubi që do të vijë do të jetë brenda standardid, po brenda këtyre parametrave, thjesht do jetë me e qartë për ankimuesin.*

Pyetje për operatorin ekonomik: *“Në vlerësimin tuaj, në mënyrë ndikon, kufizon pjesëmarrjen, shtrembëron apo kufizon konkurrencën, mënyra e hartimit të specifikimeve teknike nga ana e autoritetit kontraktor? Pse e bën të pamundur pjesëmarrjen tuaj në këtë procedurë prokurimi ose në mënyrë mund të çënojë zbtimi i projektit nga ana e operatorit ekonomik fuesme specifikimet teknike të vendosura nga ana e autoritetit kontraktor?”*

Përgjigjja e ankimuesit: *“Fillimisht në kemi kërkuar disa ndryshime në specifikimet e tubacionit të celikut, për të mos krijuar keqkuptime në specifikimet teknike. Së pari, është shprehur që tubacioni është kërkuar dimension/diametri 6 inch, ku kryesisht punohet me diametrin nominal që është shprehur 6 inch, dhe i përket diametrit 168.3mm sipas ASME B 6.10 M, i cili i referohet standardi API 5L. API 5L përcakton mënyrën e prodhimit të tubacioneve i referohet një ASME B36.10 M, që përcakton standard për diamtrin nominal 6 inch, dhe diametrin e jashtëm 168.3 mm për tubot me spesor, me trashësi 6.35 sipas kërkesve të këtij projekti. Mënyra e të shprehurit që duhet korigjuar, për të përcaktuar saktë, pra bëhet*

*fjalë për diametrin nominal, e cila u pranua nga ana e autoritetit kontraktor. Së dyti, është grada e celikut e cila është kërkuar grada A, A 25 nga API 5 L grada A25 është limituar deri në tubot me diametër 4 inch, ose më saktë me diametër më të vogël se 141.3 mm, pra në rastin tonë është tub me diametër 150mm dhe gradë A25, nga API5L nuk është i vlefshëm. Edhe gjithashtu, edhe sikur autoriteti shprehu që nuk kufizon, por do të ishte më qartë të shprehi grada A ose grada B. Për sa i përket përbërjeve kimike, kemi rekomanduar se duke qënë se është refruar një standard API 5L, atëhere do të ishte më e qartë edhe përbërja kimike, pra kufizimit min/max të jetë sipas këtyre në standard. Pra në vlerat që ka standardi, që të mos të ketë keqkuptime apo konfuzion.*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuzë, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë ato specifikime teknike për pajisjet objekt prokurimi të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në këtë seancë dëgjimore operatori ekonomik ankimues pretendon që specifikimet teknike të kërkuara të jenë në fashën minimum sipas standardit të vendosur. Komisioni sqaron se, operatori ekonomik ankimues nuk ka kundërshtime në lidhje me standardin e vendosur në specifikime teknike por ajo çka pretendohet nga ankimuesi është që për sa kohë që autoriteti kontraktor ka vendosur standardin përkatës të lejohet një diapason në lidhje me përbërjen kimike, vetitë fiziko-mekanike dhe elementëve të tjerë në përputhje me diapazonin e përcaktuar në standardin për tubin sipas diametrin  $\Phi$  të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Në përfundim të këtij seksioni në lidhje me sa u deklarua më lartë, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor ka sqaruar se nuk ka as limitim dhe as kufizim për ofertuesit, por përderisa kërkohet që të jenë më të qarta dhe të jetë diapason më i gjërë ka rënë dakort që, për të qënë sa më të qarta, pranon të rishikohen dhe të saktësohen këto paqartësi. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të qartësojë dhe saktësojë specifikimet teknike për tubin e celikut për sa i përket standardit të venë nga kjo e fundit. Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor, si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe hartimit të kritereve të kualifikimit, duhet të modifikojë këtë specifikim teknik, në përputhje me paqartësit e parashtruara në këtë seancë dëgjimore, për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: “5-. Dokumenti

*“Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 32 e dokumentit, kapitulli 8, paragrafi 8.4 pika a, Matës i tipit CORIOLIS, sipas të cili kërkohet:*

*‘....Montimi: M Fallanxha DN150 PN64 sipas DIN2501/EN1092-1” bie në kundërshtim me Kapitullin VI, seksioni 6.1 Të përgjithshme, paragrafi fundit, sipas të cilit:*

*“Të gjitha vlerësimet e presionit/temperaturës për komponentët me fllanxha duhet të jetë në përputhje me ASME B16.5 përveç kasteve kur parashikohet ndryshe...”*

*Projektuesi ka për detyrë të saktësojë në mënyrë të qartë standardet për tu përdorur. Nëpërmjet këtyre specifikimeve projektuesi ka përmend dhe standartet amerikane ASME dhe europiane sipas DIN. Projekti në mënyrë që të zbatohet saktë duhet të ketë unifikim të standardeve, për këtë arsye projektuesi duhet të saktësojë që komponentët e fallanxhave që do të furnizohen duhet të jenë të gjitha ose sipas standardeve amerikane ASME ose sipas atyre europiane. Prandaj kërkohet nga autoriteti kontraktor të bëjë ndryshimet e mëposhtme:*

*Është:*

*“...Montim me Fallanxha DN150 PN64 sipas DIN2501/EN1092-1”*

*Të bëhet:*

*“..Montim me Fallanxha DN150 PN 64 sipas DIN2501/EN1092-1 ose ASME B16.5 ekuivalente”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.7.1. Dokumentacioni “Specifikimet teknike të ndryshuar, pdf”, i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga ana e autoritetit kontraktor, ku citohet:

- *Montimi; Me fllanxha DN150 PN64 sipas DIN2501/EN1092-1.*

III.7.2. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

5. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

6. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."*

III.7.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e

kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një*



specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter alia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.7.4. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin “Secifikime teknike të ndryshuara pdf,” pretendon se: *duhet të ketë unifikim të standardeve të përdorura dhe autoriteti kontraktor të bëjë ndryshimet e mëposhtme:*

*Është: “...Montim me Fallanxha DN150 PN64 sipas DIN2501/EN1092-1”*

*Të bëhet: “..Montim me Fallanxha DN150 PN 64 sipas DIN2501/EN1092-1 ose ASME B16.5 ekuivalente”.*

Në lidhje me pretendimet e ankimesit, Komisioni iu drejtua me pyetje autoritetit kontraktor: *“pse janë përdorur dy lloj standardesh të ndryshme në hartimin e specifikimeve teknike, konkretisht një standard amerikan në hartimin e specifikimeve teknike të tubit dhe dy standard në hartimin e specifikimeve për montim Fallanxhash, pasi kjo mund të krijojë konfuzion për operatorin ekonomik në momentin e ofertimit të mallrave objekt prokurimi dhe pse janë përzgjedhur këto dy lloj standard?”.*

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor sqaron se: “nuk krijon konfuzion, pasi është përmendur standardi amerikan, është përmendur edhe europiani, është përmendur termi ekuivalent dhe në pikën 6.2 të specifikimeve kemi referencë edhe standardet që janë përdorur dhe në këtë pikë janë përmendur standardet përkatëse që operatori ekonomik kërkon, kshu që nuk ka kufizim përderisa thuhet që ky standard ose ekuivalent, ankimuesi mund të përdori atë amerikan, mund të përdorin edhe europianin, kjo pikë nuk krijon kufizim, dhe është përmendur standardi përkatës që përmendet nga ankimuesi”.

Gjithashtu, Komisioni iu drejtua edhe operatorit ekonomik: “se pse në vlerësimin e tuaj këto specifikime teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe mund të kufizojmë konkurrencën duke bërë në pamundësi ofertimin? ose janë të parqarta?”.

Ankimuesi sqaroi se: “në seksionin 6.1 për specifikimet e përgjithshme për fllanxhat kërkohet pra sipas ASME B16.5 përveç rasteve ku parashikohet ndryshe, ndërkohë për Coriolis montimi i kërkuar me fllanxa sipas DIN, sipas një standardi europian. Ne kërkojmë që aty të shprehet si DIN ose ASME B 16.5, pra të lë dy variantet, që të jetë e unifikuar lloji i fllanxhës gjatë gjithë instalimit, të shmanges mundësia e përdorimit të dy fllanxhave të ndryshme brenda një instalimi. Në këtë mënyrë i lë mundësinë operatorit ekonomik në mnyrë që të zgjedhë që në fillim dhe është unifikuar gjatë gjithë projektit. Pra që të mos jetë e kufizuar me ASME B 16.5 dhe në një vënd tjetër të jetë ose ekuivalente dhe në një vënd tjetër të jetë DIN. Në çdo rast rekomandoj të jetë përcaktuar edhe ekuivalenti i tij. Rekomandimi jonë ka qenë që për këtë pajisje të jetë specifikuar edhe termi ekuivalent pas çdo standardi të shprehur”.

Në përfundim të këtij seksioni në lidhje me sa u deklarua më lartë, përfaqësuesi i autoriteti kontraktor ka sqaruar se nuk ka as limitim dhe as kufizim për ofertuesit, por përderisa kërkohet që të jenë më e qartë ka rënë dakort që pranon të rishikohen dhe të saktësohen këto paqartësi. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të qartësojë dhe saktësojë specifikimet teknike duke vendosur termin ekuivalent pas çdo standardi të caktuar prej tij.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: “7-. Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 31 e dokumentit, kapitulli 8, paragrafi 8.4 pika a, Matës i tipit CORIOLIS, është kërkuar që matësi i tipit Coriolis të ketë komunikim nëpërmjet protokollit MODBUS, PROFIBUS DP, EtherNet/IP, PROFINET, MODBUS TCP, **Ëeb**server në Ethernet dhe gjithashtu është kërkuar që kjo pajisje të ketë certifikim MID. Një matës me këto protokolle komunikimi nuk mund të certifikohet sipas MID. Gjithashtu, në mënyrë që të përcaktohej saktë Matësi Coriolis, atëhere projektuesi duhet të jepte të dhënat si më poshtë:

- Diapazoni i prurjeve minimale-maksimale;
- Viskoziteti i fluidit (cP);
- Klasifikimi i zonë dhe lloji i mbrotjes ATEX.

Në mënyrë që të përmasohet Matësi i Tipit Coriolis atëhere projektuesi dhe për rrjedhojë autoriteti kontraktues duhet të ndryshojë specifikimet teknike të këtij produkti duke shtuar edhe parametrat e mësipërme. Prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktortë marrë parasysh këtë ndryshim, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Dokumentacioni “Specifikimet teknike të ndryshuar, pdf”, i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga ana e autoritetit kontraktor, ku citohet:

- Daljet/Komunikimi; HART®, Modbus®, PROFIBUS DP®, EtherNet/IP™, PROFINET®, Modbus® TCP, Webservice ne Ethernet.

III.8.2. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.8.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve

të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrencë të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Evropian vs. Mbretëria e Holandës” inter alia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”**

KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.8.4. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin "Specifikime teknike të ndryshuara pdf," pretendon se: *është kërkuar që matësi i tipit Coriolis të ketë komunikim nëpërmjet protokollit MODBUS, PROFIBUS DP, EtherNet/IP, PROFINET, MODBUS TCP, Eëbserver në Ethernet dhe gjithashtu është kërkuar që kjo pajisje të ketë certifikim MID. Një matës me këto protokolle komunikimi nuk mund të certifikohet sipas MID. Gjithashtu, në mënyrë që të përcaktohej saktë Matësi Coriolis, atëhere projektuesi duhet të jepte të dhënat si më poshtë:*

- Diapazoni i prurjeve minimale-maksimale;
- Viskoziteti i fluidit (cP);
- Klasifikimi i zonë dhe lloji i mbrotjes ATEX.

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua autoriteti kontraktor: "Çfarë është certifikimi MID, për tu kuptuar nga ana e Komisionit? Pse mungesa e të dhënave shtesë nga ana e autoritetit kontraktor, e bëjnë të pamundur apo mund të ndikojë në pamundësi nga ana e operatorit ekonomik, është vlerësuar kjo nga ana e autoritetit kontraktor? Pra, çfarë është certifikimi MID? Si lidhet ky certifikim me komponentët e kërkuar në lidhje me tipin e matësit nga ana e autoritetit kontraktor?"

Përgjigjia e përfqësuesit të autoriteti kontraktor: "në lidhje me këtë pikë, për ta bërë më të qartë, në tubacion do të instalohet një matës që është dixhital dhe i cili ka një sensor që mat prurjet, temperaturën, ka dhe një transmetues. Sqarimi, që ndoshta nuk është kuptuar në specifikimin teknik, protokollit MODBUS, është protokollit i komunikimit të transmetuesit me pajisjet të jashtme, pra midis sensorit të matësit dhe transmetuesit. Kjo mun dtë jttë keqkuptuar. Teknologjia që është kërkuar është dixhitale- online, që nëpërmjet internetit apo teknologji analoge për të bërë komandimin në distancë, mbyllje apo hapje automatike, marrje të dhënash online në cdo moment dhe për të rrspektuar këtë lloj protokollit, ky tilloj kunimkim është për pasjiejn e vet matesit me transmetues të jashtëm, dhe jo vet pasjiejn me transmetuesin.

Pra, Komisioni nga sa u tha më sipër, nga sa ka deklaruar përfaqësuesi i AK, nuk ka ndonjë ndalim nga certifikimi MID në lidhje me parametrat e kërkuar nga ana AK, nuk ka një mospërputhje midis çfarë parashikon standardi i certifikimit të kësaj pajisje me mënyrën e transmetimit të të dhënave.

Përfaqësuesi i AK sqaron më tej se: "Në lidhje me klasifikimin e zonave ATEX është përmendur , e rishikuar në shtojcën e DT, që është klasifikuar zona, lloji i linjës, llojin e materialit, objektin në vetvete, është klasifikuar si zonë ATEX, që ka të bëjë më sigurinë. Pra është dhënë si zonë klasifikimi. Lloji i materialit është që kemi të bëjmë me naft bruto, me parametrat përkatës, të gjitha këto kanë qenë në detyrë projektimi në relacion dhe në specifikime. AK i ka ngakuar këto dokumenta. Duke sqaruar edhe një herë që kjo ka qenë linjë ekzistuese, nuk është bërë linjë e re, ka qenë cdo gjë aprori e përcaktuar, zëvendësim i atij ekzistues. Normalisht duke përmirësuar parametrat si siguri, si në cilësi, si në jetëgjatësi, duke marrë parasysh edhe

korrozionin, që ka qenë shkaku kryesor që tubi është amortizuar, plus edhe vitet. Pra, janë marrë parasysh të gjitha këto, janë përmendur standardet, janë përmendur specifikimet, një oE me përvojë në këtë lloj fushe e din cfarë kërkon, e din cfarë po bën. Është dhënë minimalia se cfarë kërkohet nga ne dhe se cfarë teknologjie po kërkohet, ajo është në varësi të prodhuesit, pasi nuk është e limituar. Mjafton që të realizojë qëllimin e projektit”.

KPP, sqaron se, nga ana e operatorit ekonomik pretendohet që të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të ofertuar dhe pretendonhet që mund të ketë vend për përmirësim në vend të përcaktimit të Diapazoni i prurjeve minimale-maksimale; Viskoziteti i fluidit (cP); Klasifikimi i zonë dhe lloji i mbrotjes ATEX.

Komisioni i drejtohet me pyetje AK: “Kjo në vlerësimin tuaj është e nevojshme për tu shtuar në specifikime?”

Përgjigjia e AK: “Mendoj që jo, duke qenë sic iu thashë që kemi të bëjmë me linjë ekzistuese, dimë përmasat, gjatësinë, dimensionin të linjës, llojin e tubit, është i përcaktuar llojin e lëngut e kemi, prurjen e kemi thënë se sa, se janë në relacion cdo gjë, cfarë prurje kemi dhe për sa kohë, teknologjia e matësit është dhënë, transmetuesi është dhënë, cafrë certifikimi duhet të ketë”.

Pyetje për operatorin ekonomik: “Pse në vlerësimin tuaj, specifikimet teknike janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin dhe pse mungesa e këtij informacioni që ju kërkoni të shtohet e bën të pamundur ofertimin nga ana juaj në këtë procedurë prokurimi?”

Përgjigjia e Ankimuesit: “Fillimisht doja të thoja që certifikimi sipas MID, është certifikim për transferime, shitje doganore dhe ka standardet ndërkombëtare OIML dhe standardi evropian MID. Protokollet e kërkuara, ku bëhet fjalë për sinjalet dalëse nga transmetuesi drejt sistemit qëndror që do të bëjë komandimin. Këto protokolle të kërkuara janë MODBUS, PROFIBUS DP, EtherNet/IP, PROFINET, MODBUS TCP, **Eeb**server. Një matës me tërë këto lloj protokolle nuk mund të certifikohet sipas certifikimit MID, pasi MID ka kufizime sa i përket protokolleve dhe komunikimit të pajisjeve, është më e kufizuar dhe ndalohet kryesisht në protokolle më të thjeshta sic janë ato analoge, komunikimet hard, ose dhe MODBUS. Por jo në të tërë protokollat e kërkuara.

Ndërsa për sa i përket matësit vet, atëhere matësi coriolis, është matës i vecantë dhe kërkon gjithashtu të njihet viskoziteti i fluidit dhe prurjet min/max të parashikuara që do të kalojnë në këtë matës. Dhe nga kjo bëhet më i saktë dhe nuk lë hapsirë për gabime gjatë parametrizimit të matësit. Prandaj, kemi kërkuar që të jetë më e plotë për të qënë edhe ne më të saktë, është më shumë plotësuese sesa kufizuese”.

Pyetje për AK: “Të dhënat e kërkuara nga operatori ekonomik ankimues a janë të identifikueshme nga ana e AK? Mund të vihen në dispozicion në këtë fazë? A janë të dhëna, pjesë e një dokumenti tjetër, pjesë e dokumentatve të procedurës së prokurimit që mund të identifikohen nga AK?”

Përgjigjia e AK: “Pra siç ju thamë, këto janë pjesë e relacionit teknik, gjithsesi për të pasur informacion më të qartë mund të kërkoi me kërkesë AK. Pra, lloji i lëngut që do të kalojë, që

*është naftë bruto, temperatura, prurja që do të jetë ditore në m<sup>3</sup>, dhe që mund të konvertohte në lit/ sekonda, sa atëherë operohet, janë dhënë në realcion teknik të projektit.*

Operatori ekonomik u shpreh që: *“Densiteti është dhënë, por është dhënë prurja nominale, prurja normale e tubacionit, dhe viskoziteti mungon”.*

Pas këtij sqarimi që bëri përfaqësuesi i autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimues, pranoi që u sqarua në mënyrë shteruese prej tij, dhe është i qartë në lidhje me pretendimin e parashtruar. Rrjedhimisht, duke qenë se operatori ekonomik ankimues është i sqaruar në lidhje me këtë specifikim teknik, pretendimi i ngritur pranë KPP-së në lidhje me specifikimin e mësipërm nuk do të merret në shqyrtim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.9.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “VIBTIS” Shpk: *“8-. Dokumenti “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 23 e relacionit, paragrafi 6.4 Tubi i Celikut, “...Për të vërtetuar cilësinë, duhet të paraqiten certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me celik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit (me markim CE) në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European”.*, Kërkesa për markim CE të tubit të celikut tregon qartë se projektuesi dhe për rrjedhojë autoriteti kontraktor që ka shpall procedurën e prokurimit bazuar mbi këto specifikime nuk ka bërë interpretimin e duhur mbi direktivën 68, të vitit 2014. Kjo për arsye se tubot e shitur individualisht dhe jo pjesë të një pajisje apo asemblimi nuk mund të markohen CE. Markohen CE vetëm Pajisja ose Asemblim Komponentësh. Për këtë interpretim i referohemi Udhëzuesit lidhur me Direktivën e Enëve nën Presion 2014/68/UE (PED), Udhëzimit A-09 të Komisionit Grupit Punës “Presioni” (ËGP) i miratuar prej tij në 08/01/2016. Prandaj kërkojmë që paragrafi:

*Është:*

*“.....Për të vërtetuar cilësinë, duhet të paraqiten certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me celik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit (me markim CE) në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European..”.*

*Të bëhet:*

*“...Për të vërtetuar cilësinë, duhet të paraqiten certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me celik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.9.1. Dokumentacioni “Specifikimet teknike të ndryshuar, pdf”, i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga ana e autoritetit kontraktor, ku citohet:

*Për të vërtetuar cilësinë , duhet te paraqiten certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove me çelik të papërzier, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit (me markim CE) në përputhje me direktivën 68 të vitit 2014 të Komitetit European.*



III.9.2. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

5. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që*

*zgjdhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.9.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet

ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larinë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”**

KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.9.4. Referuar legjisllacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës

dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin "Specifikime teknike të ndryshuara pdf," pretendon se: *Për të vërtetuar cilësinë, duhet të paraqitet certifikata e përputhshmërisë për kontrollin e prodhimit, bazuar në standardin për ndërtimin e strukturave të tubove të celikut të pa përzierë, pjesë e kërkesës së mësipërme, si dhe certifikata e materialit në përputhje me direktivën 86 te vitit 2014 të Komitetit European*".

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua autoriteti kontraktor: *"A keni bërë ndonjë verifikim, nëse është i aplikueshëm certifikimi me markën CE për këtë mall objekt prokurimi në përputhje me direktivën dhe legjislacionin në fuqi në Shqipëri?"*

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor ka sqaruar se: *"në lidhje me certifikim CE të produktit është thënë në specifikime teknike dhe sqaruar në shtojcë, që është kërkuar që materiali dhe prodhimi nga furnitori potencial të jetë sipas certifikimit CE që kërkon norma e europiane (bashkimi european). Tubi mund të prodhohet në Kinë, Indi apo kudogjetkë por mjafton që të jetë projektuar sipas certifikimit CE, që do të thotë që prodhuesi vetë, teknologjia dhe pajisja të jetë sipas certifikimit CE dhe nuk është thënë apo kërkuar që tubi magjstral si material final të ketë markim CE. Ndoshta kjo është keqkuptuar apo ka qenë e paqartë, por autoriteti ka kërkuar që të jetë sipas certifikimit CE për prodhimin, për materialin, për teknologjinë, që të jetë e pranueshme për Komitetit European. Dhe jo vetë tubi si copë fizike, që të ketë markimin CE, si produkt final, por të jetë i prodhuar, si materiali dhe teknologjia sipas markimit CE"*.

Pra, Komisioni evidentoi se, nga ana e AK, në qëllimin e detyrës e projektimit është kërkuar që vetë materiali itë jetë i prodhuar me certifikimin CE por nuk është kërkuar që elementë të vet tubit të vijnë me markimin CE.

Pas këtij sqarimi që bëri përfaqësuesi i autoritetit kontraktor, operatroi ekonomik ankimues, pranoi që u sqarua në mënyrë shteruese prej tij, dhe është i qartë në lidhje me pretendimin e parashtruar. Rrjedhimisht, duke qenë se operatori ekonomik ankimues është i sqaruar në lidhje me këtë specifikim teknik, pretendimi i ngritur pranë KPP-së në lidhje me specifikimin e mësipërm nuk do të merrret në shqyrtim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "VIBTIS" Shpk: *"10- Dokumenti "3.Specifikime teknike të ndryshuara. pdf" Faqe 28 e dokumentit, Kapitulli 8, paragrafi 8.2, Mënyra e Funksionimit të Sistemit", projektuesi ka specifikuar që duhet parashikuar kontrolli automatik i valvolave ON-OFF, por nuk ka parashikuar Pasojën në rast se mbyll valvulën në mënyrë automatike se çfarë ndodh më tej me grupin e pompimit. Projektuesi në mënyrën e Funksionimit të Sistemit duhet të kishte parashikuar edhe kontrollin e grupit të popimit. Në rast se valvula mbyllet automatikisht ndërkohë që grupi i popimit vazhdon të qëndrojë në punë, atëhete në tubacion krijohet rritje presioni dhe më tej shpërthim. Projektuesi duhet të kishte parashikuar kontrollin automatik edhe të grupit të pompimit, i cili do të mundësonte fikjen emergjente të grupit të popimit në të njëjtën kohë që mbyllet edhe valvula ON-OFF. Ky funksion duhet të ishte pjesë e një sistemi të vetëm komunikimi, por*

projektuesi e ka bërë pjesërisht duke mos ndërlidh komunikimin me gjithë sistemin dhe për pasojë rrezikimin e jetës dhe sigurisë në punë. Për sa më lart kjo ishte detyrë e Porjektuesit për ta parashikuar dhe më tej autoriteti kontraktor që ka pranuar këtë projekt për ta shpallur në procedurë prokurimi. Mungesa e trajtimit të duhur të kësaj çështje mund të shkaktojë dëme me pasojë për punonjësit e autoritetit kontraktues dhe nënkontraktorëve të cilët punojnë me zonën e tubacionit dhe stacioneve pompimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1. Dokumentacioni “Specifikimet teknike të ndryshuar, pdf”, i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga ana e autoritetit kontraktor, ku citohet:

## **8.2 MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT**

Sistemi i propozuar do të funksionojë me anë të kombinimit të teknologjisë GPRS dhe sistemit të kontrollit të programueshëm (PLC). Njësitë matëse matin parametrat e kërkuar, dhe ja transmetojnë këto parametra valvules së kontrollit me anë të sistemit të kontrollit të programueshëm. Njëkohësisht të gjitha paisjet matëse dhe ato të kontrollit transmetojnë informacionet/leximet në serverat online me anë të sistemit GPRS.

GPRS dhe PLC janë sisteme standarte për komunikimin midis paisjeve të ndryshme të kontrollit, dhe bën të mundur komunikimin e paisjeve në distanca të largëta me njëra tjetrën dhe me përdorim minimal energjie.

Sistemi do të përbëhet nga tre pjesë kryesore :

- a. Leximi i parametrave.
- b. Valvolat automatike ON-OFF.

c. Kontrolli automatik i valvolave ON-OFF dhe leximi në distancë i treguesve të njërive matëse (Matësi i prurjes Coriolis dhe Sensori i presionit) dhe statusit të valvolave të kontrollit.

**a. Leximi i parametrave**

Leximi i parametrave do të bëhet me anë të dy paisjeve kryesore, matesi i prurjes me metodologjine e matjes Coriolis, dhe Sensori i presionit.

Matësi i prurjes me metodologjine Coriolis, instalohet në tubacion me anë të fllanxhave, dhe bën leximin automatik të prurjes, vëllimit, shpejtësisë, dhe parametrave të tjerë të lëngut në tubacion, sipas nevojave. Matësi përbëhet nga dy pjesë, sensori dhe transmetuesi, dhe furnizohet me rrymë elektrike. Bazuar në praktikat ndërkombëtare, metodologjia Coriolis është metodologjia më e saktë për matjen e prurjes në lëngje.

Sensori i presionit, instalohet në tubacion me anë të një saracineske me filetim, e cila lidhet me tubacionin me anë të një tubi të shkurtër që saldohet direkt mbi tubacion. Ky sensor bën leximin në kohë reale të presionit në tubacion.

**b. Valvolat automatike ON-OFF**

Valvolat ON-OFF, mund të jenë të tipit flutur, globe, ball valve, etj, me kushtin e vetëm që të jenë të përshtatshme për përdorim në industrine e naftes dhe gazit, dhe të kontrollohen në mënyrë automatike me anë të një aktuatori elektrik. Këto valvola shërbejnë për lejimin dhe/ose ndërprerjen e transmetimit të lëngut në tubacion.

Valvolat instalohen në tubacion me atë të fllanxhave.

Aktuatori që bëjnë komandimin e valvolës, është me furnizim me rrymë elektrike dhe montohet në pjesën e sipërme të aksit të valvolës.

**c. Kontrolli automatik i valvolave ON-OFF dhe leximi ne distance i treguesve të njërive matëse(Matësi i prurjes Coriolis dhe Sensori i presionit) dhe statusit të valvolave të kontrollit**

Ky sistem monitorimi është konceptuar të përbëhet nga pjesët si më poshtë:

- Monitorimi i leximeve të matesit të prurjes.

Vlerat e parametrave të matura nga matësat e prurjes, do të transmetohen në serverin e dedikuar online me ane të një Data Logeri GPRS. Më pas, të gjithë parametrat e matur mund të aksesohen online, nga personat e autorizuar. Ky funksion nuk ndikon në rrjedhen e lëngut në tubacion, ose në vete punën e matesave.

- Monitorimi i leximeve të sensorit të presionit.


Sensori i presionit është i lidhur njëkohësisht me dy njësi transmetimi të leximit. Njëra njësi është Data Logeri GPRS, i cili bën të mundur transmetimin e matjes së presionit në serverin e dedikuar online, dhe njësia e dytë është njësia PLC, e cila bën të mundur komandimin automatik të valvolës ON-OFF, në varësi të luhatjve të presionit në tubacion.

- Monitorimi dhe kontrolli automatik i valvolave ON-OFF.

Valvolat automatike të kontrollit, kontrollohen me ane të njësisë PLC. Kjo njësi merr sinjal nga sensori i presionit mbi gjëndjen në tubacion, dhe në baze të rënies ose rritjes së presionit ne tubacion, bën hapjen dhe mbylljen e valvolës se kontrollit.

Njëkohësisht me anë të njësisë së transmetimit Data Logger GPRS, bëhet i mundur dhe transmetimi i statusit të valvolës në serverin e dedikuar online.

Një paraqitje skematike se si është parashikuar të funksionojë sistemi, është së më poshtë :



III.10.2. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj

*pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”*

III.10.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë



diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, ligjëvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrencë të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin publik" KE, parashikohet se: "*Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim*". Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "*specifikim teknik*" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 "Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të*

*dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.10.4. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizmin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, KPP vëren, se operatori ekonomik në lidhje me dokumentin “Specifikime teknike të ndryshuara pdf,” pretendon se: *“Dokumentit “Specifikime teknike të ndryshuara. pdf” Faqe 28, kapitulli 8, paragrafi 8.2 mënyra e funksionimit të sistemit, projektuesi ka specifikuar që duhet parashikuar kontrolli automatik i valvolave ON-OFF, por nuk ka parashikuar pasojën në rast se mbyll valvulën në mënyrë automatike se çfarë ndodh më tej me grupin e pompimit. Projektuesi në mënyrën e funksionimit të sistemit **duhet të kishte parashikuar edhe kontrollin e grupit të pompimit.**”*

Në lidhje me pretendimet e ankimuesit, Komisioni iu drejtua përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues: *“se pse ky specifikim teknik i hartuar nga AK, e bën të pamundur ofertimin e tuaj në këtë procedurë prokurimi, është kufizuesë dhe e paqartë?”*.

Ankimuesi sqaroi se: *“kjo është më shumë në aspektin e rekomandimit në ato që quhen për praktika zbatimi. Ne kemi rekomaduar atë lloj funksioni pasi siç është argumentuar në ankesën tonë”*.

Për sa më sipër, Komisioni evidentoi se, në gjykim e operatorit ekonomik, nuk është se ky specifikim teknik mund të çënojë konkurrencën, thjesht ankimuesi kërkon që të jetë më e qartë në rastin e zbatimit të kontratës, nëse do të jenë fitues të kësaj kontrate. Gjë, e cila u pranua nga vet ankimuesi.

Në lidhje me këtë pikë, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor sqaroi se: *“thjesht për sqarim siç tha edhe ankimuesi, nuk ka kufizim të konkurrencës, thjesht ka nevoj për sqarime për të qenë edhe më e qartë për ata, por është sqaruar se çfare linjë kemi të bëjmë, çfare funksioni ka pasur, stacioni i pompimit që shtyn lëngun naftë bruto është i amortizuar por nuk ka qënë qëllimi i këtij projekti, dhe monitorimi në pesë pika të kësaj linje, që është afro 6 km, ky sensor automatik, në momentin që do të bie presioni, do të bëjë mbylljen që mos te kemi rrjedhje të*

*panevojshme, ndotje të mjedisit, humbje apo tj. Përveç kësaj, është pretenduar nga ankimuesi që mund të ketë rritje të presionit, ndërkohë që pompa punon, e cila është e vërtetë edhe kjo. Por duke qenë se ajo është pajisje elektronike dhe ka një farë diapazoni min/max të operimit të presionit, në momentin që rritet presioni mbi atë që ka të lejuar tubi dhe pajisja, ajo rihapet përsëri duke lejuar shkarkimin, për të evituar shkatërrim apo shpërthim të tubit në vend tjetër, dhe mbi të gjitha duke qenë se do të ketë transmetim dixhital, në kohë reale, do të merret informacion se çfarë po ndodh me linjën. Duke qenë se Albpetrol sha, e përdor këtë linjë, një herë në javë me një sasi të caktuar, ata janë gjithë kohës në monitorim se çfarë po ndodh tek linja dhe personat që janë në gadishmëri në stacionin e pompimit, e marrin informacionin nga saraçineska e parë që është hapur, të stacionit, se çpo ndodh më poshtë, do bëjë fikjen e pompave. Kjo normalisht është lënë mundësia që nesër, kur këta të kenë mundësi të rinovojnë pompat, të kenë edhe panele të reja elektronike, softstarter, ku dhe ndezja dhe fikja e pompave të bëhet automatike, për që i përket një faze tjetër. Momentalisht për të ofertuar, është mëse i mjaftueshëm informacioni”.*

Pas këtij sqarimi që bëri përfaqësuesi i autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimues, pranoi që u sqarua në mënyrë shteruese prej tij, dhe është i qartë në lidhje me pretendimin e parashtruar. Rrjedhimisht, duke qenë se operatori ekonomik ankimues është i sqaruar në lidhje me këtë specifikim teknik, pretendimi i ngritur pranë KPP-së në lidhje me specifikimin e mësipërm nuk do të merrret në shqyrtim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merrret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendosi:**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “VIBTIS” SHPK, për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Zëvendësim i pjesëshëm i tubacionit magjistrat Ø 6" nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje ” me Nr. REF-91395-12-18-2023 me fond limit: 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “VIBTIS” SHPK për modifikim të dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet e nevojshme, në sistemin elektronik të prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “VIBTIS” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiorent Zguro</b>	<b>Anila Malaj</b>	<b>Kreshnik Ternova</b>
	<b>Kryetar</b>	
	<b>Jonaid Myzyri</b>	

